



***Raport i konsoliduar mbi
përmirësimin e Efiçencës së
Energjisë në Ndërtesa
në Shqipëri dhe Kosovë***

*Magdalena Blachowiak
Valbona Mazreku
Arion Sauku
Burim Ejupi
Sabit Gashi*

Dizenjuar nga



Ky projekt është pjesë e Iniciativës Evropiane për Klimën (EUKI) i Ministrisë Federale Gjermane për Çështje Ekonomike dhe Veprim Klimatik (BMWK). Projekti "RenovAID - Mbështetje strukturore shumë-nivëlëshe për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në ndërtesa në Kosovë dhe Shqipëri" synon të rrisë efiçencën energjetike të ndërtesave në këto rajone. Efiçenca e energjisë është thelbësore për pakësimin e lëshimit të gazeve serrë, uljen e kostove të energjisë dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky raport konsolidon gjetjet nga studimet gjithëpërfshirëse të kryera në Kosovë dhe Shqipëri, jep njohuri mbi pengesat aktuale dhe propozon rekomandime të zbatueshme për politikën dhe zbatimin praktikë për të përmirësuar efiçencën e energjisë në ndërtesa.

Raporti jep një pamje të gjendjes aktuale, sfidave dhe rekomandimeve për përmirësimin e efiçencës së energjisë në ndërtesa në Kosovë dhe Shqipëri. Gjetjet kryesore zbulojnë pengesa të rëndësishme si kufizime financiare, mungesë ndërgjegjësimi publik dhe korniza të papërshtatshme politike. Raporti thekson nevojën për mbështetje të konsiderueshme financiare, fushata ndërgjegjësimi publik dhe zbatim ligjor më të rehtë për të arritur qëllimet për efiçencën në energji.

Përpjekjet e përbashkëta midis organeve qeveritare, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare janë thelbësore për të çuar përpara programin e efiçencës së energjisë në përputhje me standardet evropiane.

Varshavë, Tiranë, Prishtinë, 2024

Supported by:



Federal Ministry
for Economic Affairs
and Climate Action



European
Climate Initiative
EUKI

on the basis of a decision
by the German Bundestag



Multi-level structural support
for improving energy efficiency
in buildings in Kosovo and Albania



ENERGIACLUB
SZAKPOLITIKAI INTÉZET
MÓDSZERTANI KÖZPONT



TABELA E PËRMBAJTJES

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.1 Pamje e përgjithshme e projektit	09
1.2 Gjetjet kyçe dhe rekomandimet bazuar në rezultatet nga Shqipëria dhe Kosova	09
	10
2. HYRJE	13
3. METODOLOGJIA	
3.1 Struktura e kërkimit dhe baza logjike	15
3.2 Modeli Irlandez	15
3.3 Modeli Francez	15
4. GJENDJA AKTUALE E EFIÇENCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA	
4.1 Përmbledhje e prireve botërore në efiçencën e energjisë	17
4.2 Sfida dhe mundësi specifike në Ballkanin Perëndimor	21
5. KUADRI POLITIK NË SHQIPËRI DHE KOSOVË	
5.1 Përmbledhje e politikave ekzistuese dhe përputhja e tyre me standartet e BE-së	25
5.2 Analiza ligjore	32
6. KUADRI POLITIK NË SHQIPËRI DHE KOSOVË	
6.1 Çështje kyçe dhe pengesa në Shqipëri	39
6.2 Çështje kyçe dhe pengesa në Kosovë	42
7. REKOMANDIME	
7.1 Rekomandime politike për Shqipërinë	47
7.2 Rekomandime politike për Kosovën	50
8. INTEGRIMI I ZGJIDHJEVE NË KORNIZËN POLITIKE	
8.1 Strategjitë për Shqipërinë	53
8.2 Strategjitë për Kosovën	55
8.3 Rruga drejt zbatimit	58
8.4 Shembuj pozitivë	62
9. PËRFUNDIMET	66
10. REFERENCA DHE BURIME	68



SHKURTIME

ANE – *Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë*

BE – *Bashkimi Evropian*

CPE – *Certifikata e Performancës së Energjisë*

DEE – *Direktiva për Efiçencën e Energjisë*

DPEN – *Direktiva për Performancën e Energjisë në Ndërtesa*

EE – *Efiçencë Energjie*

PKEEER – *Projekti i Kosovës për Efiçencë Energjie dhe Energji të Rinovueshme*

VKM – *Vendim i Këshillit të Ministrave*





1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 PAMJE E PËRGJITHSHME E PROJEKTIT

Projekti RenovAID është një nismë strategjike për të rritur efikasitetin e energjisë në sektorët e ndërtimit në Kosovë dhe Shqipëri, në rrugëtimin e tyre drejt standardeve të energjisë të Bashkimit Evropian. I financuar në kuadër të Iniciativës Evropiane për Klimën, projekti synon të trajtojë nevojën urgjente për të ulur emetimet e gazeve serrë, për të ulur konsumin e energjisë dhe për të rritur sigurinë energjetike në këto rajone.

Kosova dhe Shqipëria përballen me sfida serioze në sektorin e ndërtimit, të tilla si infrastruktura e vjetëruar, shkallë e lartë varfërie energjetike dhe mungesa e një kuadri gjithëpërfshirës politikash. Projekti RenovAID përqendrohet posaçërisht në këto çështje, duke ofruar mbështetje strukturore në shumë nivele përmes rekomandimeve politike, programeve të ngritjes së kapaciteteve dhe fushatave të ndërgjegjësimit.

AKTIVITETET KYÇE TË PROJEKTIT PËRFSHIJNË:

- Zhvillim planesh afatgjata rinovimi për Prishtinën dhe Tiranën, duke përfshirë rekomandime politike sipas sfidave specifike me të cilat përballen secili kryeqytet.
- Ngritja e një kuadri për Certifikatën e Performancës Energjetike (CPE) për të përmirësuar rregullimin dhe transparencën e konsumit të energjisë në ndërtesa dhe ngritja e zyrave me një ndalesë për të përmirësuar proceset e rinovimit për pronarët e shtëpive dhe bizneseve.
- Ndërmarrja e programeve për ngritje kapacitetesh për të rritur ekspertizën e qeverisë vendore dhe kombëtare për efikasitetin e energjisë.
- Kryerja e konsultimeve me palët e interesuara për të gjetur pengesat në sektorët e ndërtimit në Kosovë dhe Shqipëri dhe për të mbledhur informacion nga institucionet qeveritare, bizneset dhe OJF-të.

- *Organizimi i punëtorive dhe trajnimeve online për të përmirësuar bashkëpunimin ndërsektorial dhe për të përhapur njohuri praktike mbi rinovimet me efikasitet në energji.*

Projekti RenovAID bashkon përvojat e partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë për të krijuar zgjidhje praktike që u përshtaten nevojave specifike të Shqipërisë dhe Kosovës. Duke trajtuar pengesat financiare, rregullatore dhe teknologjike, projekti kontribuon në qëllimin më të gjerë të uljes së konsumit të energjisë në ndërtesa dhe përmirësimit të kushteve të jetesës.

1.2 GJETJET KYÇE DHE REKOMANDIMET BAZUAR NË REZULTATET NGA SHQIPËRIA DHE KOSOVA

Në Shqipëri, është bërë përparim i konsiderueshëm në promovimin e efikasitetit të energjisë në sektorin e ndërtimit, veçanërisht nëpërmjet futjes së certifikimeve të performancës së energjisë për ndërtesat e reja dhe të rinovuara. Gjithsesi, disa vështirësi ende pengojnë miratimin e gjerë të praktikave me efikasitet energjetik. Kostot e larta fillestare për rikonstruksionet, krahas kufizimeve në financim, përbëjnë një sfidë të madhe për pronarët e pasurive. Përveç kësaj, kuadrin kompleks rregullator të Shqipërisë i mungojnë udhëzime dhe stimuj të qartë, duke krijuar pengesa administrative. Mbështetja në teknologji të vjetruar e ndërlikon më tej integrimin e sistemeve moderne me efikasitet energjetik. Ndërgjegjësimi publik për efikasitetin energjetik mbetet i ulët, me një të kuptuar minimal të përfitimeve të tij afatgjata, që ngadalëson miratimin e masave për kursimin e energjisë.

Në Kosovë, sektori i ndërtimit është përballur me sfida të ngjashme. Pavarësisht miratimit të legjislativës kyçe, siç është Ligji “Për performancën energjetike në ndërtesa” i vitit 2016, vonesat në zbatim kanë penguar ecurinë e duhur. Mungesa e të dhënave të besueshme mbi konsumin e energjisë kufizon vendimmarrjen dhe përcaktimin e përparësive në investime, ndërkohë që kuadrin rregullator të Kosovës ende nuk pajtohet me standardet e BE-së, siç është Direktiva “Për performancën energjetike të ndërtesave”. Barrierat financiare vazhdojnë me



politika fiskale që nuk arrijnë të mbështesin teknologjinë e ndërtimit me efikasitet energjetike. Përveç kësaj, kapaciteti i ulët institucional në nivel vendor ndikon në monitorimin dhe zbatimin e standardeve për efikasitet energjetike.

Për të trajtuar këto sfida, si Shqipëria dhe Kosova lypset të prioritojnë zhvillimin e kuadrit rregullator mbështetës që përputhet me standardet e BE-së dhe pakëson barrën administrative. Krijimi i mundësive të financimit, të tilla si kredi me interes të ulët dhe subvencione për rikonstruktime me efikasitet energjetike, do të zbusnin kufizimet financiare. Programet e ndërtimit të kapaciteteve për profesionistët e ndërtimit dhe institucionet e qeverisjes vendore janë thelbësore për përmirësimin e ekspertizës teknike dhe aftësive zbatuese. Fushatat e ndërgjegjësimit publik që nxjerrin në pah përfitimet nga efikasiteti energjetik dhe programet mbështetëse në dispozicion do të nxisnin gjithashtu një angazhim më të gjerë. Duke integruar këto zgjidhje në politikat e tyre, të dy vendet mund të krijojnë sisteme më të forta mbështetëse për efikasitetin energjetik dhe të përputhen me objektivat e qëndrueshmërisë së BE-së.



2. HYRJE

Përpjekjet për efikasitet energjetike në ndërtesa janë një element kyç në zbatimin e ndryshimeve klimatike, sigurimin e sigurisë energjetike dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. ***Projekti RenovAID, që synon rritjen e efikasitetit energjetike në ndërtesa në Shqipëri dhe Kosovë, trajton këto objektiva kyçe.*** Shqipëria dhe Kosova po përjetojnë ndryshime të rëndësishme për tu përafëruar me standardet e efikasitetit energjetike në Bashkimin Evropian (BE), si pjesë e aspiratave të tyre për t'u bashkuar me BE-në. Pavarësisht progresit, të dy vendet ende përballen me sfida të rëndësishme, duke përfshirë infrastrukturën e vjetëruar, burimet e kufizuara financiare dhe mungesën e ndërgjegjësimit publik.

Ky raport konsolidon gjetjet nga një hulumtim i imtësishëm i kryer mbi efikasitetin e energjisë në Shqipëri dhe Kosovë, me një fokus të veçantë në kuadrin ligjor, barrierat dhe mundësitë. Ai mbështetet në analizat e paraqitura në raportet e mëparshme mbi gjendjen e kuadrit politik dhe konsultimet me palët e interesuara, të cilat ofruan një pasqyrë të plotë të sfidave në sektorin e ndërtimit. Këto përfshijnë kufizimet financiare, hendeqet teknologjike dhe nevojën për një angazhim dhe zbatim më të fortë të publikut.

Objektivi kryesor i këtij raporti është të japë një vlerësim të qartë të gjendjes aktuale për efikasitetin e energjisë në sektorin e ndërtimit në Shqipëri dhe Kosovë dhe të japë rekomandime të zbatueshme për përmirësimin e politikave, ndërgjegjësimin publik dhe integrimin e teknologjive me efikasitet energjetike. Këto rekomandime janë hartuar që këto vende të mund të përmbushin standardet e BE-së, të zvogëlojnë varfërinë energjetike dhe të arrijnë kursime të dukshme në planin afatgjatë.



3. METODOLOGJIA

3.1. STRUKTURA E KËRKIMIT DHE BAZA LOGJIKE

Ky raport mbështetet në gjetjet dhe njohuritë e mbledhura nga dy raportet të mëparshme, duke u përqendruar veçanërisht në sfidat në performancë dhe efikasitet energjie. Vijimësia në kërkim lejon një kuptim më gjithëpërfshirës të çështjeve kryesore dhe prirjeve të reja në këtë fushë. Gjithsesi, për të vërtetuar më tej gjetjet e mëparshme dhe për të kuptuar më thellë gjendjen aktuale, ky raport sjell të dhëna shtesë cilësore nga intervistat me aktorë institucionalë dhe jo-institucionalë. Këto intervista u hartuan për të eksploruar përmasa të reja të sfidave të njehsuara në raportet e mëparshme, duke verifikuar gjithashtu saktësinë e gjetjeve.

3.1. STRUKTURA E KËRKIMIT DHE BAZA LOGJIKE

Të dhënat për këtë raport u mbledhën përmes një kombinimi pyetësorësh, intervistash dhe grupesh fokusi. Intervistat përfshijnë palë të interesuara kryesore nga sektori publik dhe privat, si zyrtarë qeveritarë, ekspertë energjie dhe përfaqësues nga organizatat joqeveritare. U zhvilluan grupe fokusi me profesionistë të industrisë së ndërtimit për të kapur një spektër të gjerë mendimesh për vënien në jetë të politikave për efikasitetin e energjisë. Këto metoda ofruan një tërësi të dhënash të dobishme, duke siguruar një pamje shumëplanëshe të gjendjes aktuale të performancës së energjisë në Kosovë dhe Shqipëri.

3.3 TEKNIKAT E ANALIZËS

Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët, duke përfshirë intervistat gjysmë të strukturuar, dhe gjetjet nga hulumtimi në tryezë u krahasuan me hamendjet fillestare nga etapat e mëparshme të këtij hulumtimi. Kjo qasje krahasuese na lejoi të vlerësonim gjetjet nga raportet e mëparshme dhe të eksploronim njohuri të reja. Procesi i analizimit ndihmoi në përimtimin e përfundimeve dhe në rekomandime të mbështetura mirë, duke u siguruar që gjetjet të jenë adekuate si nga ana kontekstuale ashtu dhe empirike.



4. GJENDJA AKTUALE E EFIÇENCËS SË ENERGJISË NË NDËRTIME

4.1 PËRMBLEDHJE E PRIRJEVE GLOBALE NË EFIÇENCËN E ENERGJISË

Efiçenca e Energjisë është përbërës kritik i strategjive globale për të ulur emetimet e gazeve serrë, për të ulur konsumin e energjisë dhe për të përmirësuar sigurinë energjetike. Meqenëse ndërtesat përbëjnë afërsisht 30% të konsumit global të energjisë dhe gati 40% të emetimeve të CO₂¹, përmirësimi i efiçencës energjetike në ndërtesa është kthyer në përparësi. Vendet në mbarë botën po miratojnë politika, teknologji dhe praktika më të mira që synojnë rritjen e efiçencës së energjisë si në ndërtimet e reja ashtu dhe në ato ekzistuese. Që nga viti 2022, mbi 60 vende kanë vënë në jetë politika mbi efiçencën energjetike në sektorin e ndërtimit, çka pasqyron një angazhim global në rritje për të ulur kërkesën për energji dhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike.

Ndërtimet me efiçencë energjie po shihen gjithnjë e më shumë si thelbësore për qëndrueshmërinë ndaj klimës, veçanërisht në rajone që njohin kushte ekstreme të motit, siç janë valët e të nxehtit ose i ftohti i acartë. Për shembull, gjatë acarit të vitit 2021 në Teksas, shtëpitë me efiçencë energjie ishin më të pajisura për t'u përballur me rritjen e ndjeshme të kërkesës për energji ², duke zvogëluar ngarkesën në rrjetin elektrik. Globalisht, ndërtesat me efiçencë energjie po luajnë rol vendimtar në stabilizimin e sistemeve energjetike gjatë pikut të kërkesës.

Nismat ndërkombëtare, siç është Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (ANE), janë thelbësore në promovimin e efiçencës së energjisë. ANE ka krijuar “Energjia në Ndërtesa dhe

¹Min, J., Yan, G., Abed, A.M., Elattar, S., Amine Khadimallah, M., Jan, A. and Elhosiny Ali, H. (2022). The effect of carbon dioxide emissions on the building energy efficiency. Fuel, [online] 326, p.124842. doi: <https://doi.org/10.1016/j.fuel.2022.124842>

²Sodoma, B. (2022). 2021 Texas cold snap urges for energy-efficiency windows in homes. [online] Austin American-Statesman. Available at: <https://eu.statesman.com/story/sponsor-story/maverick-windows/2022/02/17/2021-texas-cold-snap-urges-energy-efficiency-windows-homes/6814648001/> [Accessed 13 Sep. 2024].

Komunitete" për të ndërmarrë kërkime dhe për të ofruar një fokus ndërkombëtar në efikasitetin e energjisë në ndërtesa³. EBC ofron udhëzime dhe korniza politike që vendet i përdorin për të përmbushur objektivat për efikasitetin në energji. Sipas ANE-s, përmirësimet në efikasitetin e energjisë kanë potencialin të ulin përdorimin global të energjisë me mbi 10% deri në vitin 2030, me kusht që politikat të zbatohen në mënyrë të efektshme⁴.

BASHKIMI EVROPIAN

Bashkimi Evropian po i prin botës në promovimin e efikasitetit të energjisë përmes një kuadri të fortë rregullator. Direktiva e BE-së për Efikasitetin e Energjisë –DEE (EU/2023/1791) dhe Direktiva për Performancën Energjetike të Ndërtesave –DPEN (EU/2024/1275) kërkojnë që shtetet anëtare të zhvillojnë plane kombëtare për efikasitetin e energjisë dhe të zbatojnë strategji për rinovimin e ndërtesave. Këto përpjekje janë pjesë e Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së, e cila synon të arrijë neutralitetin klimatik deri në vitin 2050. Vlen të përmendet që strategjia e BE-së "Vala e Rinovimit"⁵, e nisur në vitin 2020, synon të dyfishojë shkallën vjetore të rinovimit të ndërtesave deri në vitin 2030, duke synuar një ulje prej 60% të emetimeve në sektorin e ndërtimit deri në vitin 2050⁶.

Një nismë që spikat është përdorimi i Certifikatave të Performancës Energjetike (CPE) në të gjithë BE-në, të cilat ofrojnë transparencë për efikasitetin e energjisë në ndërtesa. Deri në vitin 2030, mund të rinovohen 35 milionë ndërtesa dhe mund të hapen deri në 160 mijë vende pune të gjelbra

³iea-ebc.org. (2021). About | IEA EBC. [online] Available at: <https://www.iea-ebc.org/ebc/about> [Accessed 13 Sep. 2024].

⁴iea.org. (2023). What does doubling global progress on energy efficiency entail? – Energy Efficiency 2023– Analysis - IEA. [online] IEA. Available at: <https://www.iea.org/reports/energy-efficiency-2023/what-does-doubling-global-progress-on-energy-efficiency-entail> [Accessed 13 Sep. 2024].

⁵A Renovation Wave for Europe - greening our buildings, creating jobs, improving lives

⁶Europa.eu. (2020). Available at: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52020DC0662>



në sektorin e ndërtimit⁷, me mbështetje të madhe financiare nga mekanizma si Fondi i Tranzicionit të Drejtë, i cili ndau 17.5 miliardë euro për të mbështetur përmirësimet në efikasitetin energjiek në rajonet e cënueshme⁸.

SHTETET E BASHKUARA

Shtetet e Bashkuara janë lider botëror në efikasitetin e energjisë, me vëmendje në mekanizmat e tregut dhe nismat shtetërore. Programe si 'Energy Star' dhe certifikimi LEED kanë nxitur praktika efikasiteti energjiek si në sektorin e banimit dhe në atë tregtar. Energy Star, për shembull, u ka kursyer sipërmarrjeve dhe konsumatorëve amerikanë më shumë se 500 miliardë dollarë në kosto energjiek që nga fillimi i vitit 1992⁹. Së fundi, Akti për Uljen e Inflacionit (IRA, viti 2022) dha mbi 50 miliardë dollarë për rinovimin e ndërtesave për efikasitetin energjiek, duke përfshirë stimuj tatimorë për pronarët e shtëpive dhe bizneseve për të përmirësuar sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar (HVAC) dhe për të përmirësuar izolimin¹⁰. Veçanërisht, nisma federale si Programi i Ndhmës për Izolimin nga Moti (WAP) kanë ulur kostot e energjisë për familjet me të ardhura të ulëta, me një mesatare prej 283 dollarë në vit¹¹.

⁷Europa.eu. (2020). INTERNAL MARKET, INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND SMES - Renovation Wave: doubling the renovation rate to cut emissions, boost recovery and reduce energy poverty. [online] Available at: <https://ec.europa.eu/newsroom/growth/items/690437/en> [Accessed 13 Sep. 2024].

⁸Widuta, A. and Jourde, P. (2020). [online] pp.2021–2027. Available at: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2020/646180/EPRS_BRI\(2020\)646180_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2020/646180/EPRS_BRI(2020)646180_EN.pdf)

⁹www.energystar.gov. (n.d.). ENERGY STAR Impacts. [online] Available at: <https://www.energystar.gov/about/impacts>

¹⁰Mills, R. (2022). The Inflation Reduction Act Could Transform the US Buildings Sector. [online] RMI. Available at: <https://rmi.org/the-inflation-reduction-act-could-transform-the-us-buildings-sector/>

¹¹Energy.gov. (2021). DOE Announces \$18.6 Million to Expand the Weatherization Assistance Program. [online] Available at: <https://www.energy.gov/articles/doe-announces-186-million-expand-weatherization-assistance-program> [Accessed 13 Sep. 2024].



KINA

Kina, konsumatori më i madh i energjisë në botë, ka bërë hapa domethënës në përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorin e ndërtimit. Plani i 14-të pesëvjeçar i qeverisë (2021-2025) përfshin objektiva ambicioze për të ulur me 13.5% intensitetin e energjisë dhe për të rritur pjesën e ndërtesave të gjelbra¹². Sipas Planit të Veprimit për Ndërtesat e Gjelbra, të gjitha ndërtesat e reja në zonat urbane duhet të përmbushin standardet për efikasitetin e energjisë.¹³

Kina po investon gjithashtu shumë në rinovimin e stokut të saj të madh të ndërtesave joefikase. Në janar 2021, Shenzhen krijoi një fond të posaçëm për zhvillimin e gjelbër dhe novator në inxhinieri dhe ndërtim që, ndër të tjera, mbështet rinovimet e gjelbra dhe rinovimet për kursim energjie në ndërtesat ekzistuese. Në vitin 2024, Shenzhen njoftoi se planifikon që, në dy vitet e ardhshme, të shpenzojë 4.16 milionë jen për rinovime për kursim energjie në ndërtesat ekzistuese.¹⁴

Për më tepër, në qershor 2023, Pekini krijoi një fond nxitës për zhvillimin e ndërtesave të gjelbra. Fondi nxitës ofron stimuj financiarë për rinovimin energjetik të ndërtesave publike dhe të ndërtesave të tjera ekzistuese. Për ndërtesat publike, shkalla minimale e kursimit të energjisë për rinovim duhet të jetë 15% për ndërtesat publike të zakonshme dhe 20% për ndërtesat e mëdha publike.¹⁵

¹²English.www.gov.cn. (n.d.). 5-year plan spotlights green development. [online] Available at: <https://english>

¹³CHINA GREEN BUILDING MARKET SNAPSHOT 2020. (n.d.). Available at: <https://edgebuildings.com/wp-content/uploads/2023/11/IFC0077-2023-China-Green-Building-Market-Maturity-Sheet.pdf>

¹⁴Bakermckenzie.com. (2024). Incentives for Green Retrofit | China | Global Sustainable Buildings Guide | Baker McKenzie Resource Hub. [online] Available at: <https://resourcehub.bakermckenzie.com/bg-bg/resources/global-sustainable-buildings/asia-pacific/china/topics/incentives-for-green-retrofit>

¹⁵Bakermckenzie.com. (2024). Incentives for Green Retrofit | China | Global Sustainable Buildings Guide | Baker McKenzie Resource Hub. [online] Available at: <https://resourcehub.bakermckenzie.com/bg-bg/resources/global-sustainable-buildings/asia-pacific/china/topics/incentives-for-green-retrofit>

Kina është në ballë të zhvillimit të qyteteve inteligjente, duke integruar rrjetet inteligjente, teknologjitë e efikasitetit energjetik dhe burimet e energjisë së rinovueshme në infrastrukturën urbane. Qytete si Shenzhen dhe Hangzhou janë pionierë në vënien në jetë të rrjeteve inteligjente që optimizojnë konsumin e energjisë dhe ulin varësinë nga lëndët djegëse fosile. Qeveria kineze ka bërë gjithashtu investime të dukshme në integrimin e energjisë së rinovueshme, veçanërisht në zonat qytetëse, gjë që u ka mundësuar disa qyteteve që të ulin emetimet e karbonit deri në 30%.¹⁶

Në përgjithësi, përpjekjet globale për të përmirësuar efikasitetin energjetik në ndërtesa po përshpejtohen. Këto përpjekje mbështeten nga kornizat rregullatore, përparimet teknologjike dhe stimujt financiarë që, së bashku, ndihmojnë në uljen e kërkesës për energji, uljen e emetimeve dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë ndaj klimës.

4.2 SFIDA DHE MUNDËSI SPECIFIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

SFIDAT

Sektori i ndërtesave të banimit në Ballkanin Perëndimor është konsumues i madh energjie, me 30% - 60% të konsumit total kombëtar të energjisë, krahasuar me 40% në BE. Pavarësisht harxhimit më të ulët të energjisë për frymë, konsumi i energjisë për metër katror ndryshon ndjeshëm në të gjithë rajonin, nga 100 kWh/m² në Mal të Zi në mbi 200 kWh/m² në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kjo kërkesë e lartë për energji dhe performancë e ulët energjetike nxitet nga disa faktorë, që përfshijnë infrastrukturën e vjetër, mirëmbajtjen e pamjaftueshme, barrierat rregullatore e ligjore dhe administrimi i dobët.

¹⁶RENEWABLE ENERGY POLICIES FOR CITIES EXPERIENCES IN CHINA CHONGLI DISTRICT TONGLI TOWN. (n.d.). Available at: https://www.irena.org/-/media/Files/IRENA/Agency/Publication/2021/May/IRENA_Policies_

SFIDAT KYÇE

• FINANCIMI I PENGESAVE PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË

TREG I FRAGMENTUAR: Ndërsa sektorët privatë dhe të biznesit kanë mundësi financimi relativisht të qasshme për përmirësimin e EE-së, ndërtesat me shumë apartamente kanë vështirësi në tërheqjen e kredive tregtare. Tregu për financimin e tyre është i pazhvilluar për shkak të pengesave të ndryshme.

• SFIDAT NË INVESTIM

PROJEKTE TË VOGLA DHE TRANSAKSIONE ME KOSTO TË LARTA: Projektet për EE në ndërtesat me shumë apartamente shpesh janë të vogla dhe më pak tërheqëse për investitorët për shkak të transaksioneve të larta.

TARIFAT E ULTA TË ENERGJISË: tarifat e ulëta ekzistuese ulin incentivat financiare për investime në EE.

ÇËSHTJE TË PËRBALLUESHMËRISË: shumë pronarë dhe qiramarrës kanë burime financiare të kufizuara, duke komplikuar investimet në EE.

VENDIMMARRJE E DOBËT E SHOQATËS SË PRONARËVE: Shoqata e pronarëve shpesh ka mangësi në marrjen e vendimeve të efektshme në lidhje me investimet në EE.

BESUESHMËRIA PËR KREDIDHËNIE: Shoqata e pronarëve dhe pronarët e shtëpive shpesh hasin sfida në besueshmërinë për marrjen e kredive, çka ndikon në aftësinë e tyre për të gjetur financim.

SISTEMET E FATURIMIT TË BAZUARANË NORMA: Sistemet e faturimit që nuk tregojnë shpenzimin real të energjisë mund të dëmtojnë motivimin për përmirësime në EE.

PRAKTIKAT INFORMALE NË NDËRTIM: Shtesat e paregjistruara dhe ndërtimet informale ndërlikojnë më tej përmirësimet në EE.



INVESTIME TË SHKURTRA: Pronarët e shtëpive shpesh kërkojnë kthim të shpejtë të investimit, që mund të mos përputhet me periudhat më të gjata të kthimit të investimit, tipike për masat e ndërmarra në EE.

- **HENDEQET POLITIKE DHE RREGULLATORE**

MBIKËQYRJE JOEFEKTIVE: Politikat dhe rregulloret aktuale që lidhen me strehimin shpesh janë të paqarta, zbatohen jo si duhet, çka i bën të paefektshme.

MOSPËRPUTHJE DHE ZBRAZËTI: Mospërputhjet mes ligjeve për strehimin dhe rregulloreve të tjera përkatëse krijojnë një kuadër rregullator të fragmentuar.

MUNDËSI PËR PËRMIRËSIM

- **TRYSNITË PËR ÇKARBONIZIM**

ANGAZHIMET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE: Ballkani Perëndimor përballet me trysni në rritje nga grupet ndërkombëtare të interesit, duke përfshirë shoqërinë civile, organizatat mjedisore dhe institucionet ndërkombëtare të financimit, për të çkarbonizuar furnizimin dhe konsumin e energjisë. Veprimet kryesore përfshijnë largimin gradual të qymyrit, miratimin e burimeve më të pastra të energjisë dhe rritjen e efikasitetit të energjisë, veçanërisht në ndërtesa.

- **PËRFITIMET NGA EFIÇENCA E ENERGJISË**

ULJA E VARFËRISË ENERGJITIKE: Përmirësimi i efikasitetit në ndërtesa mund të ulë faturat e energjisë, duke zvogëluar varfërinë energjitike.

PËRFITIMET EKONOMIKE DHE MJEDISORE: EE e përmirësuar mund të nxisë rritjen ekonomike përmes krijimit të vendeve të punës në ndërtim dhe lëndë ndërtimi, të përmirësojë cilësinë e ajrit dhe të ulë emetimet e dëmshme.

REFORMA TARIFORE TE ZBUTURA: Përmirësimet në EE mund të ndihmojnë në kompensimin e ndikimit të rritjes së tarifave të energjisë duke ulur konsumin e përgjithshëm të energjisë, duke minimizuar kështu faturat e energjisë familjare, duke ruajtur ose rritur nivelin e rehatisë.



- **DETYRIME LIGJORE PËR TË ARDHMEN**

OBJEKTIVAT E BE-SË DHE KOMUNITETIT TË ENERGJISË:

Paketa e Komunitetit të Energjisë "Energji e Pastër për të Gjithë Evropianët" përfshin objektiva ambicioze për vitin 2030 për efektshmëri në energji dhe energjinë e rinovueshme. Kjo do të vendosë standarde më të rrepta ndërtimi, përdorim të shtuar të energjisë së rinovueshme në ngrohje dhe ftohje, dhe efikasitet më të lartë në sistemet e ngrohjes qendrore. Përputhshmëria do të kërkojë investime të konsiderueshme në rinovim.

DIREKTIVA E EFIÇENCËS SË ENERGJISË: DEE e ndryshuar përcakton një ulje prej 11.7% në konsum energjie deri në vitin 2030, krahasuar me parashikimet e skenarit bazë të vitit 2020, që do të ndikojë në objektivat e rinovimit të ndërtesave.

DIREKTIVA E PERFORMANCËS ENERGJETIKE NË NDËRTESA: DPEN vë si kusht zhvillimin e një Strategjie dhe Udhërrëfyesi Kombëtar Rinovimi afatgjatë, si dhe promovimin e mekanizmave financiarë siç janë hipotekimet për efikasitet energjetike dhe partneritetet publik-privat.

DIREKTIVA E ENERGJISË SË RINOVUESHME II: DERII synon të integrojë energjinë e rinovueshme në sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, duke nxitur më tej nevojën për rinovime të thella që përfshijnë teknologji të rinovueshme.

- **MOMENTI POLITIK**

DEKLARATA E SOFIES: Në samitin e Sofies në 2020, drejtuesit e Ballkanit Perëndimor nënshkruan Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, u angazhuan që të mbështesin skema rinovimi të ndërtimeve, sigurimin e financimeve dhe forcimin e rregulloreve për efikasitetin e energjisë. Ata ranë gjithashtu dakord që të zhvillojnë programe për trajtimin e varfërisë energjetike dhe skema financimi për rinovimin e shtëpive.



5. KUADRI POLITIK NË SHQIPËRI DHE KOSOVË

5.1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I POLITIKAVE EKZISTUESE DHE PËRPUTHSHMËRIA E TYRE ME STANDARDET E BE-SË

SHQIPËRIA

- **PLANI KOMBËTAR PËR ENERGJINË DHE KLIMËN (PKEK) 2022-2030**

Qeveria e Shqipërisë miratoi Planin e parë Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) më 29 dhjetor 2021. Ky plan integron politika dhe masa për të përmbushur objektivat klimatike, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe Kontributet e Përcaktuara Kombëtarisht (NDC) të përcaktuara gjatë COP21. PKEK synon të harmonizojë politikat e energjisë dhe klimës së Shqipërisë për të arritur objektivat e saj klimatike.

Pas dorëzimit të tij, Sekretariati dha 50 rekomandime për të përmirësuar PKEK-në. Bazuar në këto rekomandime, PKKE përvijon strategjitë për të ulur konsumin përfundimtar të energjisë me 9.4%, vënia në jetë e të cilit pritet të fillojë në vitin 2024.

- **PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË (PKVEE)**

PKVEE, që është përbërës thelbësor i PKEK-së, u është nënshtruar rishikimeve për të përfshirë rekomandimet nga Komuniteti i Energjisë. PKVEE synon një ulje prej 9.4% të konsumit përfundimtar të energjisë në vitin 2030 duke nisur nga viti 2024.

Shqipëria ka miratuar PKVEE-në e parë, të dytë dhe të tretë, secili prej tyre përcakton objektivat e efikasitetit të energjisë në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë banesat, shërbimet, industrinë dhe transportin, me vlerësime për kursimin e energjisë në bujqësi. Masat fillestare të PKVEE-së u mbështetën kryesisht nga institucionet ndërkombëtare të



financimit, donatorët dhe kreditë e bankave lokale tregtare. Me ecjen përpara, përshkallëzimi i veprimeve për efikasitet energjie do të kërkojë rritje të financimit vendas, si publik ashtu dhe privat. Për ta mbështetur këtë, ligji për EE kërkon krijimin e një Fondi për Efikasitetin e Energjisë për të lehtësuar financimin e projekteve në EE.

- **PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR BURIMET E RINOVUESHME (PKVER)**

PKVER përshkruan objektivat për energjinë e rinovueshme të Shqipërisë në sektorët e energjisë elektrike, transportit dhe ngrohjes. Ai përputhet me detyrimet e Shqipërisë sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë për të përmbushur direktivat e BE-së mbi burimet e energjisë së rinovueshme. Plani përcakton një rritje të energjisë së rinovueshme nga 38% e konsumit total përfundimtar të energjisë në vitin 2020, në 42.5% në vitin 2030. Shqipëria ka miratuar PKVER-in e parë dhe të dytë, që përcaktojnë objektiva specifike për integrimin e energjive të rinovueshme.

- **KUADRI LIGJOR**

Ligji “Për efikasitetin e energjisë” nr.124, datë 12.11.2015, i ndryshuar me ligjin nr.28, datë 8 mars 2021, përputhet pjesërisht me Direktivën e BE-së 2012/27/BE për efikasitetin e energjisë. Ai përfshin dispozita nga direktivat e mëparshme (2009/125/KE, 2010/30/BE) dhe shfuqizon ato të vjetëruara (2004/8/KE, 2006/32/KE). Ligji është hartuar për të rritur efikasitetin e energjisë në të gjithë Shqipërinë duke përcaktuar kërkesa dhe masa të ndryshme.

Ligji “Për performancën energjetike të ndërtesave”: Shqipëria e miratoi ligjin nr.116/2016 për tu përfaqësuar me Direktivën e BE-së “Për Performancën Energjetike të Ndërtesave” (DPEN), duke urdhëruar që ndërtesat e reja publike të përmbushin standardin e Ndërtesave me Konsum Thuajse Zero Energji (NGZE).

Ligji “Për etiketimin e produkteve që lidhen me energjinë” nr.68, datë 21.06.2012 zbaton Direktivën e BE-së 2010/30/BE, e cila kërkon që konsumatorët të informohen rreth konsumit të energjisë së produkteve që lidhen me energjinë.

Ligji “Për burimet e energjisë së rinovueshme”: Ligji i miratuar rishtazi “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, në përputhje me Direktivën e BE-së 2018/2001, paraqet risi të rëndësishme, duke përfshirë të drejtat e komuniteteve të energjisë së rinovueshme për të prodhuar, konsumuar dhe shitur energji të rinovueshme. Ai zëvendëson tarifat nxitëse me mekanizma mbështetëse konkurruese. Ligji “Për bioenergjinë” është ende në pritje të miratimit.

• **AKTET NËNLIGJORE PËR EFIÇENCËN E ENERGISË**

- **VKM NR.852, DATË 7.12.2016** ‘Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë për Efiçencën e Energjisë’.
- **VKM NR.407, DATË 19.06.2019** ‘Për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve dhe përvojës profesionale për energjinë, i cili përcakton procedurat, kategoritë dhe kërkesat për lëshimin e certifikatave të auditimit të energjisë’.
- **VKM NR.342, DATË 22.05.2019** ‘Për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve për auditorët e energjisë’.
- **VKM NR.256, DATË 27.03.2020** ‘Mbi metodologjinë e llogaritjes së niveleve optimale të koston për performancën minimale energjetike të ndërtesave, njësive dhe elementëve të ndërtesës’.
- **VKM NR.537, DATË 8.07.2020** ‘Mbi kërkesat minimale të performancës energjetike dhe elementëve të ndërtesave’.
- **VKM NR.934, DATË 25.11.2020** ‘Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për mënyrën e përzgjedhjes së certifikatave të performancës energjetike të ndërtesave që do tu nënshtrohen vlerësimit dhe procesi i monitorimit të tyre’.

- **VKM NR.1094, DATË 24.12.2020** ‘Për miratimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes së performancës energjetike të ndërtesave’.

Këto masa dhe plane ligjore pasqyrojnë zotimin e Shqipërisë për të përmirësuar efiçencën e energjisë, për të rritur kontributin e energjisë së rinovueshme dhe për tu përafruar me standardet dhe direktivat e BE-së.

KOSOVA

Korniza e politikave energjetike të Kosovës është zhvilluar ndjeshëm vitet e fundit, veçanërisht me miratimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës 2022–2031. Ky dokument strategjik përcakton pesë objektiva kryesore që synojnë modernizimin e sektorit të energjisë dhe afrim më të madh me standardet e BE-së.

- **OBJEKTIVI 1: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit**

Ky objektiv fokusohet në rritjen e qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së përgjithshme të sistemit energjetik të Kosovës, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji dhe duke trajtuar sfidat teknike që lidhen me infrastrukturën.

- **OBJEKTIVI 2: Çkarbonizimi dhe promovimi i energjisë së rinovueshme**

Në përputhje me politikat energjetike të BE-së, Kosova synon të ulë emetimet e karbonit duke rritur pjesën e energjisë së rinovueshme në strukturën e vet energjetike. Ky objektiv përfshin përpjekje të rëndësishme për promovimin e energjisë diellore, eolike dhe ujore si pjesë e agjendës për çkarbonizimin e vendit.

- **OBJEKTIVI 3: Rritja e Efiçencës së Energjisë**

Kosova i kushton rëndësi të madhe përmirësimit të efiçencës së energjisë në të gjithë sektorët. Kjo është në përputhje me direktivat e BE-së mbi efiçencën e energjisë, veçanërisht në sektorin e ndërtesave dhe atë industrial, ku ekziston potencial i madh për uljen e konsumit të energjisë dhe përmbushjen e objektivave të kursimit të energjisë.

- **OBJEKTIVI4: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut**

Kosova synon të nxisë bashkëpunimin rajonal, i cili është thelbësor për përmirësimin e sigurisë energjetike dhe integrimin e tregut. Kjo vjen në linjë me strategjinë e Bashkimit Energjetik të BE-së, që promovon integrimin e tregjeve të energjisë ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve fqinje.

- **OBJEKTIVI 5: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve**

Strategjia përmban dispozita për mbrojtjen e konsumatorëve, veçanërisht të grupeve vulnerabël, dhe fuqizimin e tyre përmes informimit dhe qasjes në burime energjie të përbalueshme dhe të besueshme. Kjo është ngushtësisht e lidhur me rregulloret e BE-së për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin energjetik.

Pavarësisht këtyre objektivave gjithëpërfshirëse, ende mbeten sfidat për t'u përafruar plotësisht me standardet e BE-së, veçanërisht në fushën e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë.

PLANI KOMBËTAR I ENERGJISË DHE KLIMËS (PKEK) është një tjetër dokument vendimtar politik që synon të përafrojë më tej politikat energjetike të Kosovës me standardet e BE-së. Megjithatë, PKEK mbetet një projekt dhe ka pasur vonesa të dukshme në miratimin e tij të plotë nga Sekretariati i Energjisë. Kjo vonesë ka penguar aftësinë e vendit për t'u integruar plotësisht në kuadrin më të gjerë të BE-së për qeverisjen e energjisë dhe klimës. Me tu finalizuar, PKEK pritet të përvijojë angazhimet e Kosovës ndaj objektivave për klimën dhe energjinë në BE për vitin 2030, duke përfshirë uljen e emetimeve të gazeve serrë, rritjen e pjesës së energjisë së rinovueshme dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

Korniza për performancën dhe efikasitetin e energjisë në Kosovë ka hedhur rrënjë në disa akte kryesore ligjore që përputhen me objektivat strategjike të vendit dhe, deri diku, me direktivat e BE-së. Më poshtë janë instrumentet kryesore ligjore që formojnë bazën për politikat e performancës energjetike në Kosovë:



LIGJET BAZË

- **Ligji nr. 06/L-079 mbi Efiçencën e Energjisë (2018)**

Ky ligj ofron bazën ligjore për promovimin e efiçencës së energjisë në të gjithë sektorët, veçanërisht në ndërtesa, dhe përcakton objektivat kombëtare për kursimin e energjisë. Ai gjithashtu paraqet krijimin e strukturave institucionale përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të masave për efiçencën në energji, duke përfshirë dhe Fondin për Efiçencën e Energjisë në Kosovë. Ky ligj e përafron Kosovën me direktivat e BE-së për efiçencën e energjisë, por është përballur me sfida në zbatim, veçanërisht në fusha kyçe si detyrimet për kurse të detyrueshme të energjisë dhe promovimi i bashkëgjenerimit me efiçencë të lartë (gjenerim i nxehtësisë dhe i rrymës nga i njëjti burim).

- **Ligji nr. 05/L-101 mbi Performancën e Energjisë në Ndërtesa (2016, 2024)**

Ky ligj synon posaçërisht përmirësimin e performancës energjetike në ndërtesa. Ai përcakton kërkesat për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rinovimin e ndërtesave për të siguruar që ato të përmbushin standardet minimale të performancës energjetike. Ligji gjithashtu paraqet certifikimin energjetik për ndërtesat, që së fundmi ka filluar të zbatohet. Ndonëse ligji përfaqëson një hap para drejt përmbushjes së standardeve të BE-së, vonesat në zbatim kanë penguar efektin e tij të plotë.

AKTET NËNLIGJORE

Përveç këtyre ligjeve, Kosova ka miratuar disa udhëzime administrative që japin udhëzime të hollësishme për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë.

Këto përfshijnë:

- **UDHËZIMI ADMINISTRATIV nr. 05/2021 “Për kornizën e përgjithshme të raportimit për efiçencën e energjisë”** – Ky udhëzim përcakton kornizën e përgjithshme për raportimin e përmirësimeve në efiçencën e energjisë në të gjithë sektorët, duke përimituar rolet e grupeve të ndryshme të interesit dhe

proceset e raportimit që duhen për përmbushjen e objektivave kombëtare të kursimit të energjisë.

- *UDHËZIMI ADMINISTRATIV nr. 10/2020 “Për metodat dhe parimet e përbashkëta për llogaritjen e ndikimit të efikasitetit të energjisë” – Ky udhëzim paraqet metodologjinë për llogaritjen e kursimeve të energjisë të arritura përmes masave të ndryshme të efikasitetit. Ai siguron që llogaritjet e kursimeve të energjisë të jenë të standardizuara dhe në përputhje me praktikën e BE-së, duke mundësuar matje dhe raportim të saktë.*

- *UDHËZIMI ADMINISTRATIV nr. 08/2020 “Për certifikatat/garancitë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga bashkëgjenerimi me efikasitet të lartë” – Ky udhëzim paraqet procesin e certifikimit për energjinë e prodhuar nga bashkëgjenerimi me efikasitet të lartë. Ai siguron që konsumatorët dhe palët e interesuara të mund të njehsojnë dhe verifikojnë burimin e energjisë elektrike të prodhuar në mënyrë të efektshme, duke mbështetur transparencën dhe përputhjen me standardet e BE-së.*

- *UDHËZIMI ADMINISTRATIV nr. 07/2020 “Për kushtet e përgjithshme për analizën kosto-përfitim lidhur me masat për promovimin e efikasitetit energjetik në ngrohje dhe ftohje” – Ky udhëzim administrativ paraqet kriteret për kryerjen e analizave kosto-përfitim gjatë zbatimit të masave për efikasitet energjetik në sistemet e ngrohjes dhe ftohjes. Qëllimi është të sigurohet që këto masa të jenë financiarisht të qëndrueshme dhe të kontribuojnë në kursimin e energjisë.*

- *UDHËZIMI ADMINISTRATIV nr. 04/2020 “Për potencialin e efikasitetit të energjisë në ngrohje dhe ftohje” – Ky udhëzim vlerëson potencialin për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorët e ngrohjes dhe ftohjes, duke dhënë udhëzime për*

maksimizimin e kursimeve të energjisë në këto fusha kritike. Ai është projektuar për të ndihmuar në përmbushjen e objektivave kombëtare për efikasitet energjie duke u përafruar me direktivat e BE-së për efikasitetin e energjisë.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV nr. 03/2020 “Për kërkesat e efikasitetit të energjisë për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror” – Ky udhëzim detyron institucionet qendrore në Kosovë që të përfshijnë kriteret e efikasitetit të energjisë gjatë blerjes së produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave. Kjo përputhet me direktivat e BE-së për prokurimin publik dhe synon të japë shembull për sektorin privat duke prioritetizuar zgjidhjet efikase energjetike në prokurimin publik.

5.2. ANALIZA LIGJORE

SHQIPËRIA

Aktet dhe rregulloret kryesore janë aktualisht në proces hartimi ose përditësimi për të zbatuar dispozitat e ligjit “Për efikasitetin e energjisë”. Direktiva për Efikasitetin e Energjisë (DEE) është transpozuar pjesërisht në legjislacionin shqiptar, transpozimi i plotë pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2024. Strategjia për rinovimin e fondit të ndërtesave, sipas nenit 2a të Direktivës 2010/31/BE, ende nuk është e disponueshme. Megjithatë, puna për Strategjinë Afatgjatë të Rinovimit ka filluar si pjesë e projektit SLED dhe Agjencia për Efikasitetin e Energjisë (AEE) po bashkëpunon me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) lidhur me këtë dokument.

Aktet nënligjore për Performancën e Energjisë në Ndërtesa janë miratuar, duke përfshirë metodologjinë për llogaritjen dhe përcaktimin e kërkesave minimale të performancës energjetike dhe certifikimin e ndërtesave. Ndryshimet në ligjin “Për efikasitetin e energjisë” kanë nxitur zhvillimin e tregut ESCO, me një rol mjaft lehtësues nga Agjencia e Efikasitetit të Energjisë. Megjithatë, fokusi aktual i Shqipërisë është te zbatimi i duhur dhe i shpejtë i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës

(PKEK), që ka rëndësi për realizimin e projekteve dhe masave efikase për të arritur objektivat e efijencës së energjisë deri në vitin 2030.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa drejt efijencës së energjisë dhe veprimeve klimatike **duke përcaktuar objektiva 2030 për efijencë energjie, duke vënë në jetë politikat dhe masat në përputhje me PKEK-në e miratuar në shkurt 2022**¹⁷. Megjithatë, këto masa nuk janë plotësisht në linjë me objektivat për vitin 2030 të përcaktuara nga Komuniteti i Energjisë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka paraqitur akte nënligjore të reja për zbatimin e Ligjit “Për efijencën e energjisë”, që përfshin planet vendore të veprimit për efijencën e energjisë dhe kërkesat për ndërtesat. Akte të tjera nënligjore që trajtojnë fusha me rëndësi, si monitorimi dhe verifikimi, detyrimet e efijencës së energjisë dhe kriteret e prokurimit publik, janë ende në proces hartimi. Për të nxitur uljen e kërkesës për energji në institucionet publike, qeveria ka urdhëruar vendosjen e masave për reduktim të konsumit të energjisë elektrike me 15%. Administruesit e emëruar për energjinë përgjigjen për monitorimin e progresit dhe raportimin, janë vënë gjoba për mospërputhje.

Ende nuk është miratuar një strategji afatgjatë për rinovimin e ndërtesave. Pas miratimit të akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të vitit 2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, Shqipëria **ka krijuar një sistem funksional për certifikimin e performancës së energjisë**. Agjencia e Efijencës së Energjisë mbështet lëshimin e certifikatave të performancës së energjisë për ndërtesat dhe mbikëqyr këtë skemë. Që nga fillimi, janë lëshuar mbi 40,000 raporte auditimi.

Sa u përket **mekanizmave të financimit për efijencën e energjisë**, nuk është ngritur ende një fond i dedikuar. Investimet në këtë fushë aktualisht kanalizohen përmes buxhetit të shtetit dhe ndihmës së huaj financiare, me fokus të veçantë te sektori i ndërtesave. Për më tepër, bankat vendore janë aktive në promovimin e efijencës së energjisë duke ofruar linja krediti

¹⁷ Annual Implementation Report- Energy Community Secretariat - 1 November 2023

për masa që, kryesisht, fokusohen në përmirësimin e izolimit termik të ndërtesave private. Këto nisma subvencionohen deri në 50% nga Bashkia e Tiranës. Zhvillimi i tregut të shërbimeve energjetike (ESCO) është në proces, por rregulloret përkatëse dhe kontratat model për kontratat e performancës energjetike ende nuk janë miratuar.

Ndryshimet në ligjin nr. 62/2012 janë thelbësore për të përafruar kuadrin kombëtar me kërkesat më të fundit të Komunitetit të **Energjisë për etiketimin e energjisë**. Miratimi i këtyre ndryshimeve është ende pezull. Ka pasur pak përparim në përditësimin e rregulloreve ekzistuese ose miratimin e rregulloreve të reja për grupet specifike të produkteve, siç kërkohet nga Vendimet e Këshillit të Ministrave të shtatorit 2014, nëntorit 2018 dhe dhjetorit 2022. Kjo mbetet një fushë që kërkon përkujdesje.

Ndërkohë që Ligji “Për eficiency e energjisë” ka paraqitur bazën ligjore për zhvillimin e një vlerësimi gjithëpërfshirës **të potencialit për ngrohje dhe ftohje efikase** në vitin 2021, ende mungon kryerja e vlerësimeve në përputhje me kërkesat e nenit 14 të Direktivës për Eficiency e Energjisë. Veç kësaj, mbetet pezull transpozimi i dispozitave që lidhen me inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit. Së fundmi, Shqipëria ka subvencionuar 2,000 familje me sisteme diellore për ngrohjen e ujit.

Shqipëria po bën përparime në eficiency e energjisë dhe rinovimin e ndërtesave, por enda ka sfida të shumta. Zbatimi efektiv i PKEK-së, zhvillimi i një strategjie afatgjatë për rinovimin dhe përafrimi me objektivat e Komunitetit të Energjisë janë thelbësore për arritjen e përmirësimeve domethënëse në eficiency energjitike. Mekanizmat e përmirësuar të financimit, përditësimet rregullatore dhe adoptimi më i gjerë i praktikave për eficiency energjetike janë kyçe për përparimin drejt qëllimeve të qëndrueshmërisë dhe uljes së konsumit të energjisë në mbarë vendin.

KOSOVA

Kuadri ligjor i Kosovës për efikasitetin e energjisë në ndërtesa ka njohur përparime të ndjeshme, por ende ka hendeqe të dukshme në përafrimin e plotë me standardet dhe direktivat e BE-së. Përparimet e vendit për të përmirësuar performancën energjetike në ndërtesa janë shfaqur në ligje kyçe si *ligji “Për efikasitetin e energjisë”* dhe *ligji “Për performancën e energjisë në ndërtesa”*. Gjithsesi, sfidat në zbatimin dhe përputhjen me direktivat e reja të BE-së kanë pengesa të mëdha për realizimin e potencialit të plotë të këtyre politikave.

Një nga shqetësimet kryesore të theksuara nga *Strategjia e Energjisë së Kosovës 2022–2031* është nevoja për rritjen e efikasitetit të energjisë në të gjitha sektorët, ku ndërtesat kanë një rol qendror. Pavarësisht kësaj përparësie, Kosova ende nuk e ka zbatuar tërësisht certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave, një kërkesë vendimtare sipas direktivave të BE-së. Mungesa e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të zbatuar certifikimi pengon aftësinë e vendit për të monitoruar dhe përmirësuar efikasitetin energjetike të ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese. Pa këto certifikata, mbetet e vështirë të nxiten masat për kursim energjie ose të vlerësohet performanca reale e fondit të ndërtesave.

Korniza ligjore e Kosovës, ndonëse pjesërisht e përafruar me standardet e BE-së, ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm për të përmbushur kërkesat e *Direktivës për Efikasitetin e Energjisë* dhe *Direktivës për Performancën e Energjisë në Ndërtesa*. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2023 thekson se ligjet e Kosovës ende duhen përditësuar për të pasqyruar kërkesat më të fundit të BE-së. Kjo përfshin miratimin e *Strategjisë së Rinovimit të Ndërtesave* dhe *Planit për Ndërtesat Gati Zero Energji (NGZE)*, të dyja thelbësore për të siguruar që ndërtimet e reja dhe rinovimet të arrijnë nivelet më të larta të efikasitetit energjetike.

Ndonëse Kosova ka bërë përparim me *themelimin e Fondit për Efikasitetin e Energjisë*, që mbështet subvencionimin e masave për kursim të energjisë në sektorin e banimit,

kapaciteti financiar dhe institucional për të vënë plotësisht në jetë masat për efikasitet energjetik mbetet i kufizuar. Fondi ofron një kornizë për subvencionimin e përmirësimeve në banesat sociale, por sektori i banimit ende përballë me barrierat e shumta financiare për rinovime me efikasitet energjetik. Veç kësaj, janë në zhvillim modele financimi fleksibël, por nevojiten mekanizma më të fortë për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë në financimin e projekteve për efikasitet energjetik.

Sa i përket përputhshmërisë me standardet e BE-së, *Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK)* i Kosovës, aktualisht në projekt, pritet të trajtojë kornizën ligjore për efikasitetin e energjisë në ndërtesa. Megjithatë, vonesat në miratimin e PKEK-së dhe aprovimin e tij nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë kanë ngadalësuar ecurinë e Kosovës në përafrimin e politikave të saj të efikasitetit me BE-në. Kjo vonesë, së bashku me sfidat në thjeshtimin e procedurave të lejeve për rinovime dhe ndërtimet e reja energjetikisht efikas, ende pengojnë zbatimin më të shpejtë të përmirësimeve të efikasitetit në sektorin e ndërtesave.

Një tjetër fushë kritike për përafrim është *nevoja për akte nënligjore* që përcaktojnë udhëzime të imtësishme për zbatimin e masave për efikasitet energjetik. Ndërsa Kosova ka miratuar disa *Udhëzime Administrative* – si ato që rregullojnë kornizën e raportimit për efikasitetin e energjisë dhe llogaritjen e ndikimit të kursimeve në energji – dispozitat e tjera kyçe, si *Certifikatat e Origjinës për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Bashkëgjenerimi me Efikasitet të Lartë dhe Analizat Kosto-Përfitim për masat e efikasitetit të energjisë*, kanë nevojë për zbatim më të fortë dhe përafrim të plotë me parimet e BE-së.

Në përfundim, kuadri ligjor i Kosovës për efikasitetin e energjisë në ndërtesa është në një trajektore drejt përafrimit me BE-në, por ende ka sfida të shumta. Përputhshmëria e plotë me Direktivën për *Efikasitetin e Energjisë dhe Direktivën për Performancën e Energjisë në Ndërtesa* kërkon rritjen e kapaciteteve institucionale, mekanizmave financiare dhe thjeshtimin e proceseve rregullatore. Përsheptimi në

miratimin dhe zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore do të jetë thelbësor që Kosova të arrijë objektivat e saj për efikasitetin e energjisë dhe të përmbushë pritshmëritë e Komunitetit të Energjisë dhe të BE-së.



6. GJETJE DHE ANALIZA

6.1 ÇËSHTJE KYÇE DHE PENGESA NË SHQIPËRI

Sektori i ndërtimit ka ecur përpara në lidhje me efikasitetin e energjisë. Procesi i certifikimit të performancës së energjisë ka filluar që nga shkurti i vitit 2021. Të gjitha ndërtesat e reja ose ndërtesat ekzistuese që i nënshtrohen një rinovimi madhor duhet të përmbushin kërkesat minimale të performancës energjetike.

Në sektorin e ndërtesave në Shqipëri, ka pengesa që frenojnë ndjeshëm adoptimin e praktikave me efikasitet energjetike. Ndërsfidat më të mëdha janë kufizimet financiare, pasi kostot fillestare për rikonstrukcionin e ndërtesave janë tejet të larta. Mjaft pronarë objekteve kanë të vështirë të përballojnë materialet, teknologjitë dhe fuqinë punëtore të nevojshme, ndërsa mungesa e opsioneve të arritshme për financim për të tilla rinovime e përkeqëson dhe më shumë këtë problem. Veç kësaj, kuadri rregullator në Shqipëri është kompleks dhe jo i mjaftë për të mbështetur përmirësimin me efikasitet energjetik në shkallë të gjerë, kornizat ekzistuese nuk japin udhëzime të qarta, stimuj ose mekanizma zbatimi për të përrudhur pajtueshmërinë dhe adoptimin e praktikave të efikasitetit të energjisë. Kjo krijon një mjedis shkurajues për palët e interesuara, që ngurojnë para pengesave burokratike dhe mungesës së qartësisë në rregulla.

Tjetër pengesë domethënëse është mbështetja e teknologjitë e vjetëruara dhe joefikiente në shumë ndërtesa. Mungesa e qasjes në teknologji moderne energjetike është efikasitet, krahas me mungesën e përvojës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e tyre, paraqet një sfidë të ndjeshme. Për më tepër, skicimi dhe struktura e ndërtesave të vjetra shpesh ndërlikon integrimin e teknologjive të reja, duke kërkuar modifikime të qenësishme. Infrastruktura ekzistuese, duke përfshirë rrjetet elektrike dhe sistemet e ngrohjes, shpesh nuk përputhet me përmirësimin e efektshëm në energji, çka pasqyron nevojë për rindërtim të gjithanshëm.

Faktorët socialë gjithashtu luajnë rol në pengimin e progresit. Ndërgjegjësimi dhe angazhimi publik në nismat për efikasitet energjitike janë të ulëta, shumë individë dhe bashkësi nuk kuptojnë qartë përfitimet afatgjata. Kjo prodhon një prioritet minimal për praktikën e efikasitetit energjetik, që përkeqësohet nga qëndresa kulturore ndaj ndryshimeve dhe preferenca për metodat tradicionale të ndërtimit.

Në tabelën më poshtë janë grupuar pengesat kryesore të hasura dhe fushat përkatëse të veprimit.

ÇËSHTJE KYÇE	PENGESA	FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMIT
Pengesat ligjore dhe rregullatore	Mungesa e një kuadri ligjor dhe procedurash administrative lehtësuese, mbivendosje ligjesh dhe rregulloresh. Një mjedis shkurajues për palët e interesuara, që i quajnë pengesat burokratike dhe mungesën e qartësisë rregullatore si frikësuese. Regjistrimi ligjor dhe përgjegjësitë që lidhen me pronësinë e përbashkët (shkallët, bodrumet, çatitë etj.). "Fondi për riparime dhe mirëmbajtje" i ndërtesës nuk është në gjendje të mbështesë investime të rëndësishme për rinovim.	Mbyllja e hendeqeve rregullatore dhe zhvillimi i një kuadri lehtësues.

<i>Pengesa Institucionale</i>	<i>Mungesa e kapaciteteve në institucionet përgjegjëse për administrimin dhe zbatimin e politikave.</i>	<i>Forcimi i kapacitetit institucional</i>
	<i>Kapacitete të dobëta institucionale të shoqatave të pronarëve në administrimin, mirëmbajtjen, hartimin, zbatimin e projekteve të ndërlikuara të investimeve dhe për sigurimin adekuat të shërbimeve profesionale.</i>	
<i>Pengesa teknike</i>	<i>Varësia nga teknologji të vjetëruara dhe joefiçente në shumicën e ndërtesave (para viteve '90).</i>	<i>Sigurimi i ndërtimit dhe zhvillimit të mjaftueshëm të kapaciteteve në industrinë e ndërtimit.</i>
	<i>Skicimi dhe struktura e ndërtesave të vjetra shpesh ndërlikon integrimin e teknologjive të reja, duke kërkuar modifikime madhore.</i>	<i>Rikonstruksioni dhe përmirësimi i ndërtesave.</i>
<i>Pengesa fiskale dhe financiare</i>	<i>Mungesa e investimeve ose subvencioneve nga qeveria për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë.</i>	<i>Rishikimi i mundësisë për mjete financimi të zgjeruara dhe novatore.</i>
	<i>Kosto e lartë fillestare për rinovimet që mund të pengojë përballueshmërinë dhe marrjen e vendimeve.</i>	
<i>Pengesa informimi</i>	<i>Mungesa e ndërgjegjësimit për përfitimet nga rinovimi dhe mungesa e të dhënave të mjaftueshme për furnitorët.</i>	<i>Mbajtja e një fushate të vazhdueshme ndërgjegjësimi.</i>
	<i>Mungesa e njohurive teknike të nevojshme për të vlerësuar dhe përcaktuar fushën teknike për rinovime me efiçencë në energji me kosto efektive.</i>	

6.2 ÇËSH TJJE KYÇE DHE PENGESA NË KOSOVË

Pavarësisht përpjekjeve të mëdha për të zhvilluar një kuadër ligjor për efikasnjë energji në ndërtesa, Kosova ende përballlet me sfida të shumta në vënien në jetë dhe zbatimin e këtyre ligjeve. Ligji nr. 05/L-101 i vitit 2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, i cili paraqiti standarde të performancës energjetike, ka nisur të zbatohet vetëm së fundmi, me lëshimin e certifikatës së parë të performancës së energjisë në vend. Kjo është një arritje me rëndësi, por vonesa në zbatim ka kufizuar përparimin në përmirësimin e efikasnjës së energjisë në të gjithë sektorin e ndërtesave. Ligji nr. 08/L-242 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, i miratuar në vitin 2023, paraqet një hap përpara, duke sinjalizuar një përkushtim të ri për përmbushjen e detyrimeve rregullatore dhe rritjen e standardeve të energjisë në sektorin e ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme.

Megjithatë, disa çështje kyçe vijojnë të pengojnë arritjen e plotë të objektivave për efikasnjë energjetike në Kosovë:

1. ZBATIM I VONUAR I DISPOZITAVE LIGJORE

Edhe pse legjisllacioni parashikon masa për efikasnjë energji, përfshirë ato që synojnë sektorin privat, zbatimi i tyre ka qenë i ngadaltë. Ligji “Për efikasnjën e energjisë” i vitit 2018, veçanërisht neni 10 që përshkruan një ‘Skemë të Detyrueshme për Efikasnjën e Energjisë’, nuk është zbatuar plotësisht. Kjo skemë është thelbësore për arritjen e kursimeve kombëtare të energjisë, pasi vendos detyrime për operatorët e sistemeve energjetike, shitësit me pakicë dhe shpërndarësit e karburanteve. Dështimi në zbatimin e këtyre dispozitave përkthehet në një mundësi të humbur në përmbushjen e objektivave për kursim energji, duke vonuar përparimin në përmirësimin e performancës energjetike.

2. MUNGESA E INFRASTRUKTURËS SË TË DHËNAVE

Një nga pengesat kryesore për vendimmarrje të efektshme dhe investime në efikasnjë energjetike është mungesa e të dhënave të imtësishme dhe të besueshme mbi konsumin e energjisë. Pa një infrastrukturë të besueshme të të dhënave, si sektori publik ashtu dhe ai privat hasin vështirësi në vlerësimin e mundësive për kursim energji, në projektimin e ndërhyrjeve

të posaçme dhe në prioritizimin e investimeve. Mungesa e treguesve të performancës dhe e të dhënave për konsumin pengon vlerësimin e efektshmërisë së masave për eficiency e energjisë dhe ngadalëson progresin drejt arritjes së objektivave për kursim energjie.

3. SFIDAT NË PËRPUTHJEN ME STANDARDET E BE-SË

Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2023 thekson disa fusha ku kuadri ligjor i Kosovës ende nuk është në përputhje me direktivat e BE-së. Për shembull, Kosova ende nuk ka përafruar ligjin “Për performancën e energjisë në ndërtesa” dhe ligjin “Për eficiency e energjisë” me direktivat më të fundit të BE-së që kërkohen nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Veç kësaj, vonesa në miratimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK), që pritet më qershor 2024, ka ngadalësuar ecurinë drejt një kuadri të integruar politik për eficiency e energjisë në ndërtesa. Mospërshtatja me Direktivën për Eficiency e Energjisë dhe Direktivën për Performancën e Energjisë në Ndërtesa të BE-së nënvizon nevojën për rregullore të përditësuara dhe mekanizma të fortë zbatimi.

4. PENGESAFINANCIARE DHE MUNGESA E INCENTIVAVE FISKALE

Kosova ende nuk ka zbatuar masa politikash fiskale që mund të nxisin përmirësimin e eficiency në energji. Mungesa e taksave mbi CO₂, skemave financiare apo incentivave fiskale pengon përvetësimin e teknologjive dhe materialeve ndërtimore eficiency në energji. Pa këto mekanizma, vështirësohet promovimi i përmirësimit në shkallë të gjerë i eficiency energjetike në sektorin e ndërtimit. Për më tepër, mungesa e një Kodi Ndërtimi që vë standarde minimale për eficiency energjie në lëndët e ndërtimit pengon modernizimin e stokut të ndërtesave në vend. Vënia e këtyre standardeve është thelbësore për të garantuar që ndërtimet e reja i përmbushin kërkesat e performancës energjetike dhe që kontribuojnë në kursime afatgjata të energjisë.

5. ECURI E NGADALTË NË ZHVILLIMIN E ENERGJIVE TË RINOVUESHME

Edhe pse Kosova, siç përmendet në raportin e Komisionit Evropian, ka hedhur hapa në prodhimin e energjisë së rinovueshme, vendi ende has pengesa në mobilizimin e investimeve për burime të rinovueshme për të përmbushur objektivat e veta për efikasitet energjie dhe për ndryshimet klimatike. Proceset për dhënien e lejeve për projekte energjie të rinovueshme, si energjia diellore dhe ajo me erë, mbeten të ndërlikuara, duke vonuar vënien në punë të zgjidhjeve të energjisë së rinovueshme që mund të kontribuojnë në efektshmërinë në përgjithësi të sistemit energjetik – përfshirë dhe ndërtesat.

6. KAPACITETI INSTITUCIONAL DHE MONITORIMI

Edhe pse Fondi për Efikasitetin e Energjisë është themeluar dhe procedurat operacionale janë në funksion, ka nevojë për forcimin e kapacitetit institucional për të zbatuar dhe monitoruar efektshëm masat për efikasitet energjetik. Pa institucione më të forta dhe mekanizma më të mirë monitorimi, Kosova do ta ketë të vështirë të arrijë kursimet në energji që përcakton strategjia e vet energjetike. Zbatimi i plotë i sistemit të certifikimit të performancës së energjisë dhe miratimi i Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave mbeten thelbësore për arritjen e objektivave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa.

ÇËSHITJE KYÇE	PENGESA	FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMIT
<i>pengesat ligjore dhe rregullatore</i>	<i>Vënia në jetë e masave të detyrueshme për efikasitet energjie është vonuar ndjeshëm.</i>	<i>Përsheptim në vënien në jetë dhe zbatimin e ligjeve ekzistuese për energjinë.</i>
	<i>Mospërputhje me direktivat e BE-së për efikasitetin në energji dhe performancën e ndërtesave.</i>	<i>Harmonizim i ligjit "Për efikasitetin e energjisë" dhe ligjit "Për performancën e energjisë në ndërtesa" me standardet e BE-së.</i>
<i>Pengesa Institucionale</i>	<i>Kapaciteti i kufizuar i institucioneve administrative për zbatimin e ligjeve për efikasitetin energjetik.</i>	<i>Forcimi i kapacitetit institucional dhe trajnim që synon autoritetet përgjegjëse për politikën dhe zbatimin.</i>
	<i>Vonesa në nisjen e sistemit të certifikimit të performancës energjetike dhe të strategjive për rinovim.</i>	<i>Përsheptim i miratimit dhe zbatimit të sistemeve të certifikimit dhe strategjive për rinovimin e ndërtesave.</i>
<i>Pengesa teknike</i>	<i>Varësia nga teknologjitë e vjetruara dhe joeficiente në shumicën e ndërtesave (para viteve '90).</i>	<i>Sigurimi i ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të duhura në industrinë e ndërtimit.</i>
	<i>Skicimi dhe struktura e ndërtesave të vjetra shpesh ndërlikojnë integrimin e teknologjive të reja, duke kërkuar modifikime madhore.</i>	<i>Sigurimi i ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të duhura në industrinë e ndërtimit.</i>



ÇËSHITJE KYÇE	PENGESA	FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMIT
<i>Pengesa fiskale dhe financiare</i>	<i>Mungesa e incentivave financiare dhe subvencioneve shtetërore për masat e efijencës energjetike.</i>	<i>Zhvilloni mekanizma financiare novatore dhe zgjeroni subvencionet qeveritare për projekte në efijencën energjetike.</i>
	<i>Kostot e larta fillestare për rinovime pengojnë investimet në efijencën energjetike.</i>	<i>Paraqisni kredi me interes të ulët dhe subvencione që rinovimet të jenë më të përballueshme për pronarët e pasurive.</i>
<i>Pengesa në informim</i>	<i>Mungesa e të dhënave të besueshme për konsumin e energjisë e bën të vështirë marrjen e vendimeve.</i>	<i>Fondi për Efijencën e Energjisë të krijojë një infrastrukturë të plotë të të dhënave për të mbështetur vendimmarrjen dhe investimet në efijencë energjetike.</i>
	<i>Ndërgjegjësim i ulët i publikut për përfitimet nga rinovimet që pasohen me efijencë në energji.</i>	<i>Vijoni me fushata ndërgjegjësimi për të informuar pronarët dhe banorët e ndërtesave mbi përfitimet nga efijenca energjitike.</i>



7. REKOMANDIME

7.1 REKOMANDIME POLITIKE PËR SHQIPËRINË NË PËRPUTHJE ME STANDARDET E BE-SË

Për të trajtuar si duhet pengesat në sektorin e ndërtesave në Shqipëri, është propozuar një grup i plotë zgjidhjesh.

LIGJE DHE PRAKTIKA RREGULLATORE

Shqipëria ka nevojë për një kuadër të fortë politikash me udhëzime të qarta, stimuj dhe mekanizma zbatimi për të mbështetur efikasitetin energjetik në të gjitha sektorët. Thjeshtimi i proceseve rregullatore dhe pakësimi i pengesave burokratike do ta bënte më të lehtë për aktorët e interesuar që të jenë në sistem dhe të zbatojnë masa për efikasitetin energjetik.

- *Mbledhje më të rrepta të tarifave të mirëmbajtjes (rregulla dhe zbatim gjyqësor);*
- *Krijimi i një rrjeti sigurie për pronarët me të ardhura të ulëta;*
- *Vendosja e standardeve minimale të performancës së energjisë për rinovim, rindërtim dhe përdorim të ndërtesave (për të përshpejtuar procesin e çkarbonizimit);*
- *Krijimi i një Fondi Rezervë të Detyrueshëm për mirëmbajtje dhe riparime, i cili mund të shërbejë si kolateral për kredi;*
- *Zbatim më i rreptë i Direktivës për Performancën e Energjisë në Ndërtesa (DPEN) dhe certifikimit të ndërtesave.*

QEVERISJE MË E MIRË

- ◆ *Emërimi i burimeve njerëzore të kualifikuara dhe me profil të ndryshëm profesional në ministritë përgjegjëse për ndërtimin dhe agjencitë e strehimit;*
- ◆ *Ngarkimi i agjencive të caktuara qeveritare për të monitoruar, rishikuar dhe verifikuar zbatimin e DPEN, duke përfshirë saktësinë e Certifikatave të Performancës së Energjisë (CPE);*
- ◆ *Sigurimi i administrimit profesional dhe kontrollit gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programeve nga bashkitë;*
- ◆ *Procedurave të thjeshta, të aksesueshme online për tendera dhe aplikime;*



♦ Krijimi i një faqeje qendrore informimi mbi disponueshmërinë e skemave të financimit për rinovimin e ndërtesave të banimit.

ASISTENCË TEKNIKE E SHTUAR

- Lehtësimi i aksesit në teknologji moderne dhe efikënte ndaj energjisë përmes programeve qeveritare ose partneriteteve publike-private. Kjo mund të përfshijë incentiva taksimi për importimin e produkteve me efikëncë energjetike ose subvencione për blerjen e këtyre teknologjive.
- Investime në ngritjen e kapaciteteve dhe programe trajnimi për profesionistët e sektorit të ndërtimit për të mbushur hendekun e njohurive. Programet duhet të fokusohen në teknologjitë më të fundit, praktikat më të mira dhe mirëmbajtjen e sistemeve me efikëncë energjetike.
- Zhvillimi dhe zbatimi i një shërbimi kombëtar të ndihmës teknike (ZIN) për të mbështetur gjetjen e nevojave për rinovime energjetike dhe për të rritur kapacitetet e:
- Shoqatave të pronarëve / ndërtesave kolektive (në bashkëpronësi);
- Administratorëve dhe ekspertëve për energjinë në bashki;
- Audituesve dhe projektuesve të energjisë;
- Ndërtuesve / kompanive të ndërtimit;
- Specialistëve në zyrat e këshillimit në bashki.
- Zbatimi i protokolleve të duhura për monitorim dhe verifikim (M&V), për të siguruar efektshmëri të programeve të investimeve.

ZHVILLIMI I INSTRUMENTEVE TË EFEKTSHME TË FINANCIIMIT

- *PARTNERITETE ME BANKA, INSTITUCIONE FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFI) DHE DONATORË: Këto institucione duhet të zhvillojnë produkte financiare të përshtatura posaçërisht për tregun e efijencës energjetike, ku përfshihen kredi të personalizuara, fonde investimi dhe opsione financimi që trajtojnë nevojat specifike dhe sfidat për rinovime me efijencë energjetike.*
- *MBËSHTETJE FINANCIARE E ORIENTUAR: Futja e subvencioneve dhe granteve posaçërisht për rinovimet energjetike mund të ulë ndjeshëm barrën financiare për pronarët. Kjo e bën më të lehtë për ta që të ndërmarrin masa me efijencë energjetike.*
- *PROGRAME DHE PARTNERITETE QEVERITARE: Zbatimi i programeve me kredi me interes të ulët përmes nismave shtetërore ose partneriteteve me institucione financiare, mund t'i bëjë më të afërta përmirësimet me efijencë në energji. Huatë duhen projektuar me kushte që nxisin investime në të tilla teknologji dhe rinovime me efijencë energjetike.*
- *NXITJA E NJË SKICIMI EFIKAS: Me shumë vlerë do të ishte që ndërtesat të qenë projektuar që të lehtësojnë rinovimet energjetike. Për ndërtimet e reja, skicimi që në krye me efijencë energjetike ul kostot e ardhshme dhe lehtëson përmirësimet. Kjo qasje ndihmon në qëndrueshmërinë e ndërtesave.*
- *INVESTIME NË INFRASTRUKTURË MBËSHTETËSE: Për ndërtesat ekzistuese, është thelbësore të investohet në përmirësimin e infrastrukturës që mbështet teknologjitë moderne – duke përfshirë rrjetin elektrik, sistemet e ngrohjes dhe pajtueshmërinë e strukturave ekzistuese me sistemet e reja. Të tilla ngritje cilësore ndihmojnë që ndërtesat të integrojnë më lehtë zgjidhjet dhe të nxisin jetëgjatësinë e tyre.*

RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK

- Zhvillimi dhe zbatimi i fushatave që synojnë politikanët dhe pronarët e ndërtesave për të shpjeguar përfitimet e shumta nga rinovimet energjetike.
- Krijimi i platformave për informim publik dhe promovim të fushatave ndërgjegjëse.

7.2 REKOMANDIME POLITIKE PËR KOSOVËN LIGJE DHE PRAKTIKA RREGULLATORE

- Qeveria e Kosovës të paraqesë standarde minimale të performancës energjetike për rinovimin, rindërtimin dhe përdorimin e ndërtesave, si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Energjisë, për të përsheptuar efikasitetin energjetik.
- Forcim në zbatimin e ligjit “Për performancën e energjisë në ndërtesa” duke vendosur sanksione të qarta për mosrespektim dhe duke siguruar certifikime të detyrueshme për të gjitha ndërtesat.
- Krijimi i një fondi të detyrueshëm rezervë për mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave, i cili mund të përdoret si kolateral për financimin e përmirësimeve energjetike.
- Zhvillimi i një programi subvencionimi që synon të ndihmojë pronarët e banesave me të ardhura të ulëta në zbatimin e rinovimeve energjetike, duke ulur barrën financiare për grupet vulnerabël.

QEVERISJE MË E MIRË

- Trajnimi i autoriteteve komunale dhe agjencive të strehimit për të administruar dhe mbikëqyrur efektshëm programet për efikasitetin energjetik në nivel vendor.
- Çaktimi i një agjencie qeveritare për të mbikëqyrur zbatimin e standardeve të performancës energjetike dhe për të verifikuar saktësinë e certifikatave të performancës së energjisë (CPE).

- Krijimi i një platforme të qendëruar për të informuar për skemat e financimit dhe mbështetjen e disponueshme për rinovimin e ndërtesave të banimit.

- Thjeshtimi i procedurave të aplikimit për projekte me efikasitet energjetike, duke e bërë më të lehtë për grupet e interesit që të kenë akses në financime dhe të marrin pjesë në programet qeveritare.

ASISTENCË TEKNIKE E SHTUAR

- Zhvilloni një program kombëtar ndihme teknike (ZIN) që jep udhëzime për pronarët e banesave, bashkitë, kontraktorët dhe audituesit e energjisë lidhur me rinovimet me efikasitet energjetike.

- Investoni në programe për ngritjen e kapaciteteve në sektorin e ndërtimit për të nxitur përdorimin e teknologjive moderne dhe me efikasitet energjetike në projektimin dhe rinovimin e ndërtesave.

- Vendosni protokolle për monitorim dhe verifikim për të siguruar që investimet me efikasitet energjetike po japin rezultatet dhe kursimet e pritura.

ZHVILLIMI I INSTRUMENTEVE TË EFEKSHME PËR FINANCIM

- Bashkëpunoni me bankat vendore dhe institucionet financiare ndërkombëtare për të krijuar produkte financiare të përshtatura, si kredi me interes të ulët dhe grante të dedikuara për rinovimet energjetike.

- Nisni një skemë financimi të mbështetur nga qeveria që ofron subvencione dhe grante për të ulur kostot fillestare të rinovimeve energjetike për pronarët e pasurive.

- Investoni në përmirësimin e infrastrukturës, duke përfshirë rrjetet elektrike dhe sistemet e ngrohjes, për të mbështetur përvetësimin e teknologjive me efikasitet energjetike në ndërtesat ekzistuese.

RRITJE E NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK

- Si pjesë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, nisni një fushatë ndërgjegjësimi për të edukuar pronarët e ndërtesave mbi përfitimet nga rinovimet me efikasitet energjetike dhe programe mbështetjeje të disponueshme.

- Krijoni një platformë informimi publik që ofron qasje të thjeshtuar në burime për efikasitet energjie dhe opsionet e financimit për përmirësime në ndërtesa.



8. INTEGRIMI I ZGJIDHJEVE NË KORNIZËN POLITIKE

8.1 STRATEGJITË PËR SHQIPËRINË

Strategjia afatgjatë për rinovimin duhet të jetë dokumenti kryesor politik për tejkalimin e sfidave në sektorin e ndërtimit. Të kuptuarit e veçorive të stokut ekzistues të ndërtesave është vendimtar për zhvillimin e strategjive të efektshme për efikasitetin energjetik. Rikonstrukcioni dhe përmirësimi i këtyre ndërtesave mund të çojë në kursime të ndjeshme të energjisë dhe përmirësim të rehatisë për banorët. Po ashtu, ofrimi i stimuljeve financiarë, si grante, subvencione, lehtësime tatimore apo kredi me interes të ulët, mund të nxisë investimet në përmirësime me efikasitetin energjetik për ndërtesat. Këto stimulje mund të ndihmojnë në kapërcimin e pengesave financiare dhe të motivojnë pronarët e ndërtesave që të ndërmarrin masa për kursimin e energjisë, si izolimi termik, ndërrimi i dritareve, përmirësimi i sistemeve HVAC dhe ndriçimi me efikasitetin të lartë.

Rritja e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e efikasitetit energjetik në ndërtesa mund të nxisë një kulturë kursimi energjetik dhe qëndrueshmërie. Fushatat edukative, punëtoritë dhe veprimtaritë informuese mund t'i bëjnë banorët e ndërtesave të vetëdijshëm për veprime të thjeshta me të cilat mund të ulin konsumin e energjisë, si rregullimi i termostetit, përdorimi i pajisjeve me efikasitetin në energji etj.

Për të integruar këto zgjidhje në kornizat aktuale dhe të ardhshme politike, Shqipëria duhet të ndjekë një qasje strategjike. Së pari, është thelbësor forcimi i kuadrit politik. Ky përfshin zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të zbatueshme që ofrojnë stimulje financiarë, udhëzime të qarta dhe rregullore të thjeshtuara për të lehtësuar përpunjen dhe përvetësimin e praktikave të efikasitetit energjetik. Politikat duhet të jenë dhe të përshtatshme për përditësim, që të përvetësojnë teknologjitë dhe praktikat më të reja.

- **Forcimi i mekanizmave të mbështetjes financiare** është hap vendimtar. Qeveria duhet të krijojë skema financimi, si subvencione, grante dhe kredi me interes të ulët, të orientuara posaçërisht për projekte me efikasitet energjie. Këto mekanizma do të ndihmonin në kapërcimin e kostove fillestare të larta, duke e bërë rinovimin energjistik më të përballueshëm për pronarët e pasurive.
- **Investimi në programe për ngritje kapacitetesh** është po aq me rëndësi. Duke mbështetur trajnimin dhe zhvillimin profesional për ata që punojnë në sektorin e ndërtimit, Shqipëria mund të sigurojë një fuqi punëtore cilësore që mund të zbatojë dhe mirëmbajë efektshëm teknologjitë me efikasitet energjie. Ky investim në kapitalin njerëzor është thelbësor për suksesin afatgjatë të nismave me efikasitet energjie.
- **Përfshirja e publikut** duhet të jetë gjithashtu përparësi. Nismat e gjera të ndërgjegjësimit për të edukuar qytetarët mbi përfitimet nga efikasiteti në energji, si nga ana mjedisore ashtu dhe ekonomike, do të ndihmojnë në kultivimin e një kulture të efikasitetit në energji. Angazhimi i komuniteteve përmes qasjeve pjesëmarrëse, si konsultime publike dhe punëtoritë, do të sigurojë që masat me efikasitet në energji të jenë në përputhje me nevojat dhe preferencat e popullsisë, duke rritur mundësinë për zbatim të suksesshëm.
- **Përmirësimi i infrastrukturës** është i domosdoshëm për të përthithur teknologjitë moderne me efikasitet energjetike. Investimet në përmirësimin e rrjeteve të energjisë, sistemeve të ngrohjes dhe infrastrukturave të tjera kyçe do të sigurojnë që këto sisteme të përballojnë kërkesat për teknologji të reja dhe të mundësojnë integrimin e tyre.

Duke trajtuar këto fusha kyçe, Shqipëria mund të krijojë një mjedis mbështetës për përhapjen e gjerë të praktikave me efikasitet energjie, çka përfundimisht passjell përmirësime të ndjeshme në sektorin e ndërtimit.

8.2 STRATEGJITË PËR KOSOVËN

Strategjia afatgjatë e Kosovës për efikasitetin e energjisë në ndërtesa duhet të përqendrohet në zbatimin e plotë të ligjit “Për performancën e energjisë në ndërtesa”. Të kuptuarit e plotë i stokut ekzistues të ndërtesave është thelbësor për hartimin e politikave të efektshme për efikasitetin në energji. Përmirësimi dhe rikonstruksioni i ndërtesave për të përmbushur standardet moderne të performancës energjetike do të sjellë kursime të ndjeshme energjie dhe përmirësim në cilësinë e jetesës për banorët. Një kombinim i stimulave financiarë, si grantet, subvencionet dhe huatë me interes të ulët, do të jetë vendimtar për kapërcimin e barrierave financiare që shpesh e pengojnë pronarin të ndërmarrë përmirësime në efikasitetin energjetike, si izolimi më i mirë, dritaret me efikasitet të lartë energjetike dhe sistemet moderne të ngrohjes.

*Për të nxitur integrimin e këtyre zgjidhjeve në kuadrin politik, Kosovës i nevojitet një plan i qartë advokimi. **Etapat e zbatimit të ligjit “Për performancën e energjisë në ndërtesa”** ofron një mundësi për të shtyrë përpara miratimin dhe zbatimin e akteve nënligjore. Një strategji kyçe do të jetë vendosja e mekanizmave të monitorimit që sigurojnë zbatim në kohë dhe efektiv të këtyre dispozitave ligjore.*

Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë (KSDW), një ngjarje e përbashkët e organizuar nga INDEP, Balkan Green Foundation (BGF), Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, GIZ dhe Zyra e BE-së, do të mbahet në fillim të majit 2025. Kjo platformë do të përkrahë miratimin dhe zbatimin e politikave për efikasitetin energjetike. Ajo do t'u mundësojë aktorëve të paraqesin gjetje, të ndajnë rekomandime dhe të angazhohen me vendimmarrësit mbi urgjencën e vënies në jetë të praktikave me efikasitetin energjetik në sektorin e ndërtesave.

Duke mbledhur ekspertë, përfaqësues të qeverisë dhe partnerë ndërkombëtarë, KSDW mund të sjellë hov për veprim politik. Veç kësaj, zgjedhjet e përgjithshme të shkurtit 2025 paraqesin një mundësi kyçe për të angazhuar partitë politike dhe kandidatët. Duke ndarë gjetjet kryesore dhe

rekomandimet nga hulumtimet që vijnë për efikasitetin energjetik në ndërtesa, partitë politike mund t'i përfshijnë këto ide në platformat e tyre. Kjo mund të sigurojë që efikasiteti energjetik të shndërrohet në përparësi në debatet kombëtare dhe të integrohet në programet e ardhshme qeveritare. Përpjekjet për advokim duhet të synojnë përfshirjen në programet zgjedhore të politikave për efikasitetin energjetik në ndërtim, duke theksuar si përfitimet mjedisore, ashtu dhe ato ekonomike.

Kosova duhet dhe të forcojë mekanizmat e saj të mbështetjes financiare. Qeveria duhet të zhvillojë skema financimi, duke përfshirë grante, subvencione dhe produkte financiare të përshtatura që nxisin rinovimet me efikasitetin në energji. Këto skema duhet të trajtojnë kostot fillestare të larta që shpesh shkurajojnë pronarët e pasurive që të ndërmarrin përmirësime në energji. Qeveria gjithashtu mund të eksplorojë partneritete me institucionet financiare ndërkombëtare (IFI) për të zgjeruar mundësitë e financimit.

Kritik është dhe ndërtimi i ekspertizës teknike. Kosova duhet të investojë në programe për ngritjen e kapaciteteve që trajnojnë aktorët kryesorë si administruesit vendorë të energjisë, kontraktorët dhe audituesit. Garantimi që sektori i ndërtimit të jetë i pajisur me njohuri dhe aftësi për të zbatuar dhe mirëmbajtur teknologjitë me efikasitetin në energji është vendimtar për suksesin afatgjatë.

Ndërgjegjësimi i publikut është tjetër përbërës thelbësor. Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë një program për të edukuar pronarët e ndërtesave mbi përfitimet nga rinovimet me efikasitetin në energji, duke përfshirë kursimet në kosto dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Fushatat dhe punëtoritë gjatë KSDW dhe përtej saj mund të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, duke nxitur një kulturë të kursimit të energjisë.

Së fundmi, përmirësimi i **infrastrukturës** për të mbështetur teknologjitë me efikasitetin në energji është i domosdoshëm. Investimet në fuqizimin e rrjeteve të energjisë elektrike,

sistemeve të ngrohjes dhe infrastrukture tjetër kritike do të sigurojnë që vendi të përballojë kërkesat e teknologjive moderne dhe të mundësojë përdorimin e tyre në mënyrë të gjerë.



8.3 RRUGËTIMI PËR VËNIEN NË JETË

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMET POLITIKE PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË 2030	AFAT SHKURTËR 0-5 VITE	AFAT MESME 6-10 VITE	AFATGJATË 10 VITE	INSTITUCIONI DREJTUES
	Shqipëria: Rishikimi i objektivave në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës të Republikës së Shqipërisë. Zbatim i plotë dhe forcim i legjislacionit për energjinë. Lehtësimi i procedurave burokratike, udhëzime të qarta.	Shqipëria: Përmirësimi i strategjive afatgjata të rinovimit në lidhje me planet e rinovimit të ndërtesave. Mekanizma zbatimi për të nxitur përputhshmërinë dhe adoptimin e praktikave eficiente në energji. Rrugëtim i qartë drejt arritjes së një stoku ndërtesash me emetim të ulët ose zero deri në vitin 2030.	Shqipëria: Monitorimi dhe arritja e objektivave. Nevojitet një qasje e integruar dhe koherencë në të gjitha politikat përkatëse për modernizimin e ndërtesave, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara, sigurinë, përballueshmërinë, aspektet mjedisore dhe të ekonomisë qarkore	Shqipëria, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
	Kosova: Miratimi i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës i Republikës së Kosovës. Garanci për zbatim të plotë të ligjit "Për performancën e energjisë në ndërtesa", me fokus në aktet nënligjore dhe zbatimin e tyre. Thjeshtimi i proceseve burokratike dhe komunikim i qartë me të gjitha palët e interesuara. Monitorimi i përputhshmërisë përmes certifikatave të performancës së energjisë dhe auditimeve.	Kosova: Integrimi i strategjive për rinovim me eficientë energjetike në Strategjinë Kombëtare të Energjisë. Vëmendje në rinovimin e ndërtesave të vjetra për të përmbushur standardet e eficientës së energjisë, duke garantuar përputhshmëri me kodet e reja të ndërtimit dhe certifikatat e performancës së energjisë.	Kosova: Krijimi i një rrugëtimi të qartë drejt arritjes së një stoku ndërtesash me emetim të ulët dhe zero deri në vitin 2030, duke garantuar përputhje me objektivat e BE-së për eficientë energjetike	Kosova: Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit

EFIÇENCA E ENERGJISË DHE
ADMINISTRIMI I NDËRTESAVE

AFAT SHKURTËR
0-5 VITE

Shqipëria:
Krijimi i një baze të dhënash për hartimin e kodeve të praktikave për efiçencën e energjisë në ndërtesa.
Krijimi i një enti administrues për asistencë teknike për efiçencën e energjisë, që përgjigjet për të ndihmuar shërbimet komunale dhe agjencitë shtetërore në hartimin e programeve për klientët mbi efiçencën e energjisë.
Hartimi i udhëzimeve për auditimin dhe raportimin e energjisë. Ruajtja e komunikimit të dyanshëm dhe të vazhdueshëm.
Sigurimi që të caktohen pika kontakti ku palët e interesuara mund të dërgojnë pyetje ose të marrin informacione të mëtejshme.
Komunikimi duhet të mbetet i hapur, autoritetet përkatëse duhet të monitorojnë vazhdimisht reagimet e palëve të interesuara dhe të trajtojnë menjëherë çdo pyetje a shqetësim.

Kosova:
Krijimi i një baze të centralizuar të dhënash për efiçencën e energjisë, për të mbështetur vënien në jetë të standardeve të performancës së energjisë dhe për të lehtësuar auditimet e ndërtesave.

AFAT MESME
6-10 VITE

Shqipëria:
Miratimi i kodeve dhe standardeve të performancës së energjisë për ndërtesat ekzistuese.
Zbatimi i standardeve që kërkojnë përmirësime në performancën energjetike të ndërtesës ose e sistemeve kur ndërmerren punime me rëndësi, pavarësisht nëse ato bënin pjesë në një rinovim për efiçencë energjetike ose jo.

Kosova:
Krijimi i një organi të ndihmesës teknike që mbështet komunat dhe agjencitë shtetërore në programet për efiçencën e energjisë. Zyrtarët e sotëm komunale për energjinë duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të arritur nivelin e këtyre organeve.

AFATGJATË 10
VITE

Shqipëria:
Hartimi i një strategjie për ngrohjen dhe ftohjen. Ofrimi i financimit për rinovimet në banesa për të rritur integrimin me rrjetin dhe çkarbonizimin e sektorit të ngrohjes.
Futja e pasaportave të rinovimit të ndërtesave për të udhëzuar pronarët në rinovimet me faza dhe ato të thelluara për efiçencë energjetike. Të vlerësohet ngritja e një komiteti të pavarur për të monitoruar ecurinë dhe për të raportuar—kjo garanton që vlerësimi të jetë objektiv dhe i besueshëm, shmang konfliktet e interesit, reale apo të perceptuara (duke qenë se ata që shqyrtojnë strategjinë dhe zbatimin e saj nuk janë të njëjtë me ata që janë ngarkuar ta realizojnë atë).

Kosova:
Hartimi i një strategjie afatgjatë për ngrohjen dhe ftohjen, e fokusuar në integrimin e energjisë së rinovueshme. Futja e pasaportave të rinovimit të ndërtesave për t'u ndihmuar pronarëve të pasurive që të planifikojnë rinovime me efiçencë energjetike.

INSTITUCIONI
DREJTUES

Shqipëria:
Agjencia e Efiçencës së Energjisë

SKEMA DHE FINANCIMI I
EFİÇËNÇËS SË ENERGJISË

AFAT SHKURTËR 0-5 VITE	AFAT MESME 6-10 VITE	AFATGJATË 10 VITE	INSTITUCIONI DREJTUES
<i>Shqipëria:</i> Përfshirja e aspekteve të efikasitetit në energjinë në sistemin e prokurimeve publike. Forcimi i institucioneve dhe programeve trajnimit për profesionistët. Bashkëpunimi me akademinë dhe institucionet kërkimore. Mund të hyhet në partneritet me organizmat akademike dhe institutet kërkimore të specializuara në efikasitetin e energjisë dhe shkencën e ndërtimit për të kryer kërkime dhe studime në fushat ku mungon informacioni. Mund të merret parasysh dhe krijimi i platformave për ndarjen e të dhënave, ku të mbledhen dhe të shpërndahen të dhëna përkatëse mbi performancën e energjisë dhe aktivitetet e rinovimit. <i>Kosova:</i> Fillimi i programeve për ngritje kapacitetsh në partneritet me universitete dhe institutet kërkimore, për të ofruar trajnim për profesionistët mbi teknikat e ndërtimit dhe rinovimit me efikasitetin në energji	<i>Shqipëria:</i> Hartimi i një programi strategjik investimi, banka të gjelbra. Lejimi i agjencive shtetërore që të kenë fleksibilitet në mënyrën e financimit të projekteve për efikasitetin e energjitë, duke përfshirë mundësinë për të pasur një fond rezervë për efikasitetin e energjisë. Kërkesë ligjore për krijimin e një Shoqate të Pronarëve të Shtëpive (HoA) dhe dhënien e personalitetit juridik – kjo krijon mundësinë për të mbledhur fonde në emër të disa pronarëve, por gjithashtu për të zbatuar mbledhjen e fondeve. Detyrimi për të kontribuar periodikisht në një fond të përbashkët për mirëmbajtjen, rinovimin dhe efikasitetin e energjisë – ky përbën zgjerim të rregullave të qeverisjes dhe, në shumë raste, tashmë ekzistojnë detyrime të tilla mes bashkëpronarëve të hapësirave të përbashkëta për ndreqje dhe mirëmbajtje. Kjo mund të zgjerohet për të mbuluar dhe përmirësimet në efikasitetin e energjisë. <i>Kosova:</i> Hartimi i një programi kombëtar investimesh për projektet e efikasitetit në energji, duke përfshirë zbatimin e një dritareje investimi për efikasitetin në energji nën Fondin e Garancisë së Kredive të Kosovës.	<i>Shqipëria:</i> Rritja e financimit për fondin e besimit për strehimin, me qëllim përmirësimin e mundësive për efikasitetin e energjitë në banesat sociale. Të garantohet që zbatimin në efektshëm i masave financiare që lidhen me efikasitetin e energjisë të aplikohet në mënyrën më të mirë në rinovimin e ndërtesave. <i>Kosova:</i> Zgjerimi i mundësive të financimit për rinovimin e banesave sociale, me përbërës të efikasitetit në energji; ofrimi i programeve të veçanta për Komunitetet e Energjisë, në kuadër të Ligjit "Për nxitjen e energjisë nga burime të rinovueshme".	<i>Shqipëria:</i> Agjencia për Efikasitetin e Energjitë, Ministria e <i>Kosova:</i> Ministria e Ekonomisë, Fondi i Garancisë kreditore të Kosovës, Universitetet e Kosovës

SKEMA DHE FINANCIMI I
EFİÇËNÇËS SË ENERGIJË

AFAT SHKURTER
0-5 VITE

Shqipëria:
Nisja e një fushate për eficientë e energjisë, materiale edukuese për shkollat.
Zhvillimi i një pakete mjetesh të posaçme për eficientë e energjisë, duke u bazuar në burime ekzistuese dhe të reja online.
Vini në dukje histori suksesi. Përdorimi i shembujve nga projekte të suksesshme rinovimi për të treguar përfitimet dhe mundësitë e strategjisë, dhe për të theksuar e shpërndarë njohuritë nga përvojat dhe praktikatat e mira.

Kosova:
Theksimi i projekteve të suksesshme të rinovimit energjetik përmes fushatave mediatike dhe punëtorive.

AFAT MESME
6-10 VITE

Shqipëria:
Një 'Zyrë me një Ndalesë' për rinovimet energjetike të ndërtesave për pronarët e shtëpive, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe palët e tjera të interesuara.
Kryerja e sondazheve dhe aktiviteteve për mbledhjen e të dhënave përkatëse.
Sondazhet e synuara dhe mbledhja e të dhënave mund të përdoren për të siguruar informacionin që mungon.
Grupet e interesit, si autoritetet lokale, organizatat profesionale dhe shoqatat e industrisë, mund të përfshihen në këto veprimtari.

Kosova:
Krijimi i një 'Zyre me një Ndalesë' për rinovimet me eficientë në energji, duke ofruar udhëzime për pronarët e shtëpive dhe sipërmarrjet.
Kjo 'Zyrë me një Ndalesë' mund të jetë pjesë e asaj që tashmë është planifikuar për investimet në burime të rinovueshme të energjisë.

AFATGJATË 10
VITE

Shqipëria:
Mbledhja dhe ndarja e të dhënave, për të përmirësuar njohuritë mbi stokun e ndërtesave dhe ndërgjegjësimin mbi konsumin e energjisë në ndërtesa. Marrja e të dhënave përmes angazhimit të palëve të interesuara. Angazhimi dhe konsultimet mund të përdoren si një mundësi për të marrë informacionin e duhur dhe njohuri të vlefshme praktike nga terreni.
Punëtoritë e dedikuara, tryezat e rrumbullakëta dhe konsultimet me ekspertë mund të përdoren dhe për të mbledhur informacionin përkatës dhe për të përfituar nga njohuritë dhe ekspertiza përkatëse.

Kosova:
Zhvillimi i një sistemi të centralizuar për ndarjen e të dhënave, për të monitoruar konsumin e energjisë në ndërtesa. Organizimi i punëtorive dhe këshillimeve me palët e interesuara, duke përfshirë zyrtarët komunalë për energjinë, me qëllim ndarjen në vijimësi të njohurive dhe përmirësimin e praktikave të eficientë së energjisë.

INSTITUCIONI
DREJTUES

Shqipëria:
Institucionet akademike,
Universiteti, OJF

8.4 SHEMBUJT MË TË MIRË

SHQIPËRIA

Në vitin 2017, Bashkia e Tiranës krijoi Fondin e Komunitetit që synon të nxisë bashkëpunim të efektshëm mes qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës në blloqet e banimit dhe për ruajtjen e mjediseve në bashkëpronësi.

Programi “Fondi i Komunitetit” synon që të nxisë bashkëpunim mes qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës në blloqet e banimit dhe ruajtjen e zonave të përbashkëta. Përmes një skeme financimi, banorët e një lagjeje në kryeqytet mund të bëhen bashkë nën drejtimin e administruesve për të përfituar nga bashkëfinancimi për projekte infrastrukturore që merren me probleme specifike në bashkësi. Programi synon të arrijë një seri objektivash që lidhen jo vetëm me përmirësime në mjediset e përbashkëta, por synojnë dhe që të ndryshojnë mendësinë për bashkëpunimin mes qytetarëve dhe institucioneve publike.

Ky program është mundësi mjaft e mirë për të shndërruar qytetarët në pjesë thelbësore të vendimmarrjes për nevojat vetjake dhe komunitare. Programi ndihmon dhe duke u dhënë atyre më shumë përgjegjësi në administrimin e fondeve dhe në mirëmbajtjen e mjediseve të përbashkëta. Një nga kriteret për dhënie të fondit është bashkëfinancimi. Bashkëfinancimi nga bashkëpronarët duhet të jetë të paktën 50% e fondit gjithsej. Kufiri për financimin arrin në 50,000 euro.

Fondi mbulon:

- Mirëmbajtje fasade.
- Punime për zhdukjen e pengesave arkitekturore dhe përshtatjen e ndërtesave për njerëzit me paaftësi fizike.
- Projekte për mirëmbajtjen ose rritjen e efikasitetit të energjisë ose që kanë ndikim pozitiv në mjedis.
- Mirëmbajtje tarracash.
- Mirëmbajtje zonash brenda blloqeve të banimit.

KOSOVA

Një nismë e rëndësishme është Projekti për Efiçencë Energjetike dhe Energji të Rinovueshme i Kosovës (KEEREP), i mbështetur nga Banka Botërore përmes një kredie IDA me vlerë 31 milion USD. Projekti synon të përmirësojë efiçencën energjetike (EE) në ndërtesa publike, të fuqizojë kornizën ligjore dhe politike të Kosovës për energjinë e rinovueshme (RE) dhe EE, në përputhje me objektivat e vendit për tranzicionin energjitik.

OBJEKTIVAT PARËSORE TË PROJEKTIT JANË:

- Pakësimi i konsumit të energjisë dhe i varësisë nga lëndët fosile në ndërtesa publike përmes investimeve në EE dhe RE, dhe*
- Fuqizim i kuadrit politik dhe rregullator për efiçencën energjetike dhe zhvillimin e energjisë së rinovueshme.*

Projekti shërben si praktikë e mirë për shkak të qasjes së strukturuar shumëelementëshe në arritjen e kursimeve në energji dhe përkrahjen e një mjedisi me energji të qëndrueshme.

Përbërësi kryesor i projektit merret me përmirësimin e performancës energjitike në godina publike, duke përfshirë qeverinë qendrore dhe ndërtesa komunale. Investimet synojnë masa si veçmimi termik, modernizimi i sistemit të ngrohjes dhe integrimi i sistemeve me energji të rinovueshme. Këto ndërhyrje synojnë kursime të verifikueshme energjie, ulje emisionesh dhe përmirësim të rehatisë së përdoruesve, duke përfshirë cilësi më të mirë ajri brenda dhe rregullim temperature. Gjasat janë që kursimi i energjisë në këto ndërtesa publike të tejkalojë 40% duke shfaqur potencial në përmirësimin e efiçencës në energji.

Për të nxitur veprimin në nivel vendor, projekti përmban një program pilot financimi që bashkitë të vënë në jetë masa efiçence në energji për mjediset që kanë në përdorim. Bashkive u kërkohet që të bashkëfinancojnë pjesë të investimit, duke testuar skemat e financimit të qëndrueshëm si pagesa të pjesshme kontraktori që mbështeten në kursime të verifikueshme energjie. Ky model përkrah ndarje përgjegjësie



dhe krijon shtigje për ngritjen e financimit komercial për nisma EE.

Projekti gjithashtu u vë rëndësi aftësive teknike ndërtimore brenda sektorit të energjisë, ku përmbledhet trajnimi i firmave dhe kontraktorëve për teknologji EE/RE, mbështetje auditimi energjie dhe mbikëqyrje në zbatimin e projektit për të garantuar cilësi dhe përputhje. Për më tepër, integron fushatat e ndërgjegjësimit publik për të theksuar përfitimet nga efienca e energjisë dhe qëndrueshmëria në ndërtesa.

PKEEER tregon sesi investimet e orientuara, të gërshtuara me masa politike dhe ngritje kapacitetesh, mund të prodhojnë përfitime ekonomike, mjedisore dhe shoqërore. Jo vetëm që pakëson shpenzimet në energji në sektorin publik por ndihmon dhe në objektivat që Kosova ka për çkarbonizimin, sigurinë energjetike dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Kjo nismë shërben si model i shumëfishueshëm për rritjen e efiençës energjetike në Ballkanin Perëndimor, duke nxjerrë në pah rëndësinë që mekanizmat e bashkëfinancimit, ekspertizës teknike dhe angazhimit të palëve kanë në arritjen e tranzicionit në energji të qëndrueshme.





9. PËRFUNDIME

Shqipëria dhe Kosova kanë njohur përparim të dukshëm në ngritjen e kornizave ligjore për përmirësimin e efikasitetit në energji. Dy ligjet e Shqipërisë "Për efikasitetin energjetik" dhe "Për performancën energjetike në ndërtesa" krijojnë themelin për ruajtjen e energjisë në sektorët privatë dhe publikë. Kosova ka miratuar ligje të ngjashme themelore, ndonëse vënja e tyre në jetë ka njohur vonesa për shkak të miratimit me vonesë të akteve nënligjore. Të dyja vendet synojnë afrim me standardet e BE-së, duke mbështetur integritetin e tyre në tregun energjetik evropian dhe lidhje më të ngushta me Komunitetin Evropian.

Sfidë mbetet përkthimi i këtyre ligjeve në realitet sepse të dyja vendet hasin kufizime në financim, ekspertizë teknike dhe zbatim praktik. Shqipëria ende duhet të hartojë një strategji rinovimi afatgjatë, gjithëpërfshirëse, ka nevojë për incentiva financiare për projekte për kursim energjie. Propozimet për financime përmbledhin bonde të gjelbra, kontrata performancë energjie dhe subvencione për pajisje dhe materiale që janë efikase për energjinë. Veçanërisht Kosova do të përfitonte nga sisteme më të mira të gjurmimit dhe monitorimit në përdorimin e energjisë, që mund të ndihmojnë në vendime të duhura politike. Të dyja vendet mund të kenë ndikim domethënës nëse fokusohen në programe për familje vulnerabël dhe me të ardhura të pakta, që mund të ndihmojnë në uljen e varfërisë energjetike. Përpjekjet e Kosovës mund të fuqizohen me fushata ndërgjegjësimi publik për të nxitur kursimin e energjisë nga pronarët dhe përdoruesit dhe duke krijuar mjete të posaçme financiare si banka të gjelbra për pronarë shtëpish me të ardhura të ulëta.

Bashkëpunimi rajonal ofron mundësi të vryera për të dyja vendet në trajtimin e sfidave që Ballkani Perëndimor ka për efikasitetin në energji. Nisma si Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe Procesi i Berlinit ngrenë një kuadër për ndarjen e njohurive, rreshtimin e politikave dhe investimin në projekte të përbashkëta. Pjesëmarrja në këto nisma do



tu lejonte Shqipërisë dhe Kosovës mbështetje shtesë teknike, financim ndërkombëtar dhe bashkërendim për zgjidhje ndërkufitare në fushën e energjisë. Veç kësaj, projektet pilot që mbështeten nga organizma ndërkombëtare mund të tregojnë praktika ndërtimi të qëndrueshëm dhe të nxisin përthithjen e teknologjive efikente në energji. Këto përpjekje mbështesin ecjen e të dyja vendeve drejt një të ardhmeje me energji të qëndrueshme dhe përshpejtojnë rrugëtimin e tyre drejt integritit me BE-në dhe ekonomisë dinamike.



10. REFERENCA DHE BURIME

<https://www.energy-community.org/implementation/report.html>

Draft-Strategjia-Kombëtare-për-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf

DISCUSSION PAPER by the Energy Community Secretariat on Riding the Renovation wave in the Western Balkans Proposal for boosting energy efficiency in the residential building sector DP 01/2021 / 25 Feb 2021

Fifth Annual Report under the Energy Efficiency Directive ALBANIA Prepared by: AGENCY FOR ENERGY EFFICIENCY, December 2021

Kosovo Energy Strategy 2022 – 2031, available at <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Energy-Strategy-of-the-Republic-of-Kosovo-2022-2031-1-1.pdf>

Kosovo Law on Energy Performance on Buildings, available at <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13176>

Kosovo Law on Energy Efficiency, available at <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18216>

Kosovo European Commission Report, available at https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en

Kosovo secondary legislation on Energy, available at <https://me.rks-gov.net/energja-2/>

Interview with Energy Expert, former employee of the Ministry of Economy

Interview with acting director of the Energy Department in the Ministry of Economy





RRETH PROJEKTIT

Duke qenë se ndërtesat kanë konsumin më të lartë të energjisë në Europë, përmirësimi i efikasitetit energjetic dhe pakësimi i shpenzimit të energjisë në to janë shtylla kryesore në çkarbonizimin e stokut të banesave më 2050, që kontribuon në vënien në jetë të Marrëveshjes së Gjellbër Europiane.

Kosova dhe Shqipëria, të dyja kandidatë potenciale për anëtarësim në BE, kanë ndër stoqet më joeficiente të banimit dhe dy nivelet më të larta të varfërisë në Evropë (përkatesisht 40% dhe 37%). Pavarësisht planeve për pakësim të konsumit, Kosova dhe Shqipëria nuk kanë kuadër të përshtatshëm politik për përmirësime – veçanërisht në sektorin e ndërtimit të banesave – dhe as masa mbështetëse që mund të nxisin rinovimin.

Duke përdorur analiza që mbështeten në prova, projekti u jep qeverive të Kosovës dhe Shqipërisë rekomandime politike për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa. Partnerët kosovarë dhe shqiptarë japin përvoja sipas dy konteksteve kombëtare dhe angazhohen me grupet e synuara, ndërsa partnerët polakë dhe hungarezë ndajnë përvojat e tyre në politikën e BE-së. Trajnimet, punëtoritë dhe këshillimet organizohen për tu dhënë qeverive qendrore e vendore njohuri dhe mjete për të zhvilluar strategji afatgjata rinovimi që përputhen me politikat e BE-së, duke përfshirë Kuadrin për Certifikatën e Performancës Energjetike.

Vëmendje e projektit është varfëria energjetike, veçanërisht e dukshme në Kosovë dhe Shqipëri. Hartohen rekomandime politike, autoriteteve vendore dhe qeverisë kombëtare u ofrohen udhëzime se si të shpërhapin te qytetarët dhe sektori privat informacionin për masat e efikasitetit në energji dhe rinovime.

Qeveritë vendore, sektori privat dhe shoqëria civile trajnohen për të ngritur ZIN si mjete për të lehtësuar dhe përshpejtuar rinovimet e duhura në ndërtesa.

Mbështetja në zbatimin në Kosovë dhe në Shqipëri të legjisllacionit të BE-së për klimën dhe energjinë mund të ndihmojë në shtrimin e rrugës së tyre drejt anëtarësimit në BE.